

THE KOSOVO BANKER

Bankat profitabile:
pozitive apo negative?

Cila është rëndësia e rritjes së financimit për energji
efiçiente dhe energji të ripërtërishme?

Aprovimi i Rregullores për Mbështetje Emergjente me
Likuiditet si dhe i Manualit të Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik
për Banka - hap domethënës në stabilitetin e sektorit bankar

Bankat profitabile: pozitive apo negative?





SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION



THE KOSOVO BANKER

IMPRESSUM

BORDI I DREJTORËVE TË SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS



Z. Ilir I. Aliu
Kryetar i Bordit,
ProCredit Bank



Z. Robert Wright
Zv. Kryetar i Bordit,
Raiffeisen Bank



**Znj. Merita
Gjyshinca-Peja**
Banka Ekonomike



Z. Abdurrahman Balkiz
Banka Kombëtare
Tregtare



Z. Richard Beasley
Banka për Biznes



Z. Alper Karakoç
IS Bank



Z. Lavdim Koshutova
NLB Prishtina



Z. Ayhan Albeyoğlu
TEB Bank



Z. Meriton Sunduri
Ziraat Bank

DREJTOR EKZEKUTIV I SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS DHE KRYEREDAKTORË

Z. Petrit Balija

REDAKTORË

Znj. Miranda Rugovaj
Zyrtare e Administratës dhe
Komunikimit



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK)

është zëri i industrisë bankare në Kosovë. SHBK bashkëpunon me Qeverinë, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, mediat dhe opinionin publik, me qëllim të mbështetjes së një industrie të shëndoshë bankare, e cila promovon zhvillimin afatgjatë ekonomik në Kosovë. SHBK lehtëson bashkëpunimin ndërmjet bankave, duke ofruar një platformë të vetme për lobim të përbashkët, si dhe për diskutimin e iniciativave të reja; identifikon dhe influencon iniciativat ligjore dhe rregullative; bashkërendon aktivitete të përbashkëta për bankat, si dhe promovon aktivitetet bankare përpara audiences së gjerë. Brenda SHBK-së operon Qendra për trajnime Bankare, e cila ofron trajnime në fushën e bankave dhe të financave.

"The Kosovo Banker" është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Botohet dy here në vit, me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. Lidhja e Pejës, p.n Zona Industriale, Prishtinë, 10000. Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com;

THE KOSOVO BANKER
MBËSHËTETET NGA FONDI EVROPIAN
PËR EVROPËN JUGLINDORE



EUROPEAN FUND FOR SOUTHEAST EUROPE
DEVELOPMENT FACILITY

PËRMBAJTJA

EDITORIALI 1-2

FJALA E KRYETARIT TË RI TË SHBK-SË 3

SEKTORI FINANCIAR 4-9

- Bankat profitabile: pozitive apo negative?
- Cila është rëndësia e rritjes së financimit për energji eficiente dhe energji të ripërtërishme?

KËNDI I EKSPERTËVE 10-14

- Mbështetja Emergjente me Likuiditet dhe Manuali i Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Banka - hapa domethënës në stabilitetin e sektorit bankar
- Teknologjia dhe sistemi bankar

KËNDI I EDUKIMIT FINANCIAR 15-22

- Big Mac dhe Pariteti i Fuqisë Blerëse, PFB
- Metodologjia Lean
- Një mundësi për përshtypje të parë mbresëlënëse

LAJMET E SHBK-së 23-30

- Sektori financiar i Kosovës përfaqësohet në Berlin
- Shoqata e Bankave të Kosovës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës
- Panairi Financiar 2015
- SHBK dhuroi shpërblimet e lojës shpërblyese "Panairi Financiar 2015"
- Ligjeratë për Edukimin Financiar nga Shoqata e Bankave të Kosovës në kuadër të Javes Globale të Ndërmarrësisë
- U mbajt tryeza e rrumbullakët me temën "E drejta e transferimit të Qirambajtjes për pronat e privatizuara në Kosovë për 99 vite: Implikimet për bizneset,

institucionet financiare dhe klientët e tyre"

- Mirëpritet banka ZIRAAT në Shoqatën e Bankave të Kosovës
- Bordi i drejtorëve në Shoqatën e Bankave të Kosovës zgjedh kryetarin e ri
- Shoqata e Bankave të Kosovës ndan mirënjohje për z. Robert Wright
- T.C. ZIRAAT BANKASI A.S. - dega në Kosovë anëtarësohet në Shoqatën e Bankave të Kosovës
- Komitetet në Shoqatën e Bankave të Kosovës Përzgjedhin Kryesinë e Re
- Banka të sigurta në Kosovë dhe Shqipëri


LAJME NGA BANKAT DHE PËRGJEGJËSIA SOCIALE 31-35

- Banka Ekonomike mbështet kongresin e dytë ndërkombëtar të oftamologëve
- Banka Kombetare Tregtare ndihmon femijet e prekur me semundjen e kancerit
- BPB sjellë buzëqeshje nxënësve të shkollës fillore Tefik Çanga
- Bizneset sllovene të interesuara për investime në fushën e mjedisit
- Banka Raiffeisen vazhdon përkrahjen për Federatën e Futbollit të Kosovës
- Banka ProCredit edhe këtë vit mbështet Dokufest-in
- e-Statement, shërbimi më i ri i lancuar nga Banka ProCredit
- TEB SH.A promovon ndërmarrësinë dhe iniciativat Start Up si mundësi e zhvillimit personal dhe ekonomik

Pikëpamjet e shprehura në shkrimet e revistës janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo politikat e Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) dhe Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE). SHBK dhe EFSE nuk mbajnë përgjegjësi mbi përmbajtjen e artikujve të autorëve të publikuar në revistën "The Kosovo Banker".



EDITORIAL



Z. PETRIT BALIJA

DREJTOR EKZEKUTIV
SHOQATA E BANKAVE
TË KOSOVËS

Të nderuar lexues,

Mirë se vini në edicionin e 8-të të revistës "The Kosovo Banker". Kam kënaqësinë që mund të ndajë me ju këtë botim të ri i cili shqyrton një temë me interes të lartë dhe me shumë debat, kohëve të fundit, që është edhe tema kryesore e këtij edicioni të titulluar "Bankat Profitabile: Pozitive apo Negative?". Qëllimi i kësaj teme është që sektori bankar të vazhdojë të diskutoj hapur dhe në mënyrë transparente të gjitha temat me interes për klientët bankar, palët me interes të sektorit financiar dhe publikun e gjerë.

Për sektorin bankar, të Republikës së Kosovës, në qendër të vëmendjes janë klientët e tyre bankar. Prandaj, është esenciale që të gjitha aktivitetet e ndërmarra, të gjitha reformat e bëra dhe të gjitha zgjidhjet e ofruara nga sektori bankar të përmbushin nevojat e

klientëve bankar. Në saje të një raporti të tillë partneriteti me klientin sektori bankar mund të rritet dhe të zgjerohet, madje edhe në një mjedis të vështirë të biznesit me të cilin po përballemi në Kosovë. Sektori bankar është i vendosur të vazhdoj t'i shërbej nevojave të ekonomisë së Kosovës përmes aktiviteteve të veta të financimit dhe shërbimeve të pagesave që janë aq esenciale për klientët individual, klientët e biznesit, institucioneve qeveritare dhe agjencive jo-qeveritare.

Në këtë edicion paraqitet një adresim i veçantë nga kryetari i ri i Shoqatës së Bankave të Kosovës, z Ilir Aliu. Poashtu, ka një numër të artikujve, shumë përmbajtësorë, që trajtojnë tema të tjera me interes si: Profitabiliteti i Sektorit



Bankar në Kosovë; Financimi i energjisë eficiente dhe energjisë së ripërtërishme; Teknologjia dhe sistemi bankar; dhe Lehtësirat e menaxhimit të likuiditetit në sektorin bankar.

Ky botim përfshin edhe tema të edukimit financiar dhe interesit të përgjithshëm, si koncepti i Paritetit të Fuqisë Blerëse, Metodologjia Lean, dhe Rëndësia e gjuhës së trupit në një mjedis profesional. Në fund të revistës, do të gjeni lajmet kryesore që shënuan sektorin bankar në gjysmën e dytë të vitit 2015 dhe aktivitetet e rëndësishme të përgjegjësive sociale të bankave të Kosovës.

Shfrytëzoj këtë rast për të shprehur një falënderim të veçantë për bankat anëtare të SHBK-së dhe Fondin Europian për Europën Juglindore (EFSE) për sponsorimin e këtij edicioni dhe një falënderim të madh, po ashtu, autorëve dhe stafit të SHBK-së që kontribuan në përgatitjen e këtij edicioni si edhe lexuesit tanë të devotshëm për mbështetjen e tyre të madhe.

Gëzuar festat dhe ju uroj një vit të begatë në 2016!

Sinqerisht,
Petrit Bališa

FJALA E KRYETARIT TË RI TË BORDIT TË SHBK-SË

Të nderuar lexues,

Në cilësi të kryetarit të Shoqatës së Bankave të Kosovës, kam kënaqësinë të ndaj me ju pikëpamjet e mia në lidhje me gjendjen aktuale të sektorit bankar në Kosovë si dhe pritjet për të ardhmen.

Që në fillim dua të theksoj se çdo vlerësim për performancën aktuale të sistemit bankar duhet të jetë i balancuar në kuptim që rezultatet padyshim pozitive të këtij viti duhet të vendosen në kontekstin e ambientit makroekonomik që lë për tu dëshiruar si në nivelin global ashtu edhe në Kosovë. Në këtë moment mund të përgëzojmë akterët në sektorin financiar të Kosovës qoftë nga ana e rregullativit ashtu edhe në sektorin komercial për punën e kujdesshme dhe konservative që kanë treguar.

Sistemi bankar në Evropë por edhe në botë po përballlet me sfida të ndryshme. Andaj edhe sistemi bankar në Kosovë nuk mund të jetë dhe nuk është imun. Disa nga këto janë: margjinat e ulëta bankare, portfolio e kredive në vonesë, rregullativa më e shtrënguar bankare dhe kostot më të larta të lidhura me të, ndryshimet teknologjike që ndikojnë në hyrjen në treg të lojtarëve të rinj si dhe rritja e kërkesave të klientëve për shërbime bankare më cilësore.

Menaxhimi i suksesshëm i këtyre sfidave është parakusht që bankat të luajnë rolin e vetë social si mbështetës të përgjegjshëm të zhvillimit të ndërmarrjeve dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi.

Sfidat e lartpërmendura nuk mund të tejkalohen me sukses nëse nuk ekziston një bashkërenditje në veprimet e institucioneve kryesore në shoqëri. Për të qenë më preciz: margjinat e ulëta bankare dhe normat e interesit poashtu të ulëta mund të jenë të qëndrueshme nëse ekziston sistem efikas i gjyqësorit i cili fuqizon zbatimin e kontratave në njërën anë dhe në anën tjetër kostot për vlerësimin e projekteve të ndërmarrjeve mund të ulen nëse ekziston përkushtim i gjithanshëm i institucioneve për implementimin e plotë të kërkesave për raportimin financiar dhe zvogëlimin e ekonomisë joformale.

Sektori bankar në Kosovë është pjesë e ekonomisë Kosovare dhe e ndan fatin e saj, andaj bankat janë

Z. ILIR I. ALIU

KRYETAR I BORDIT
TË SHOQATËS
SË BANKAVE TË
KOSOVËS,

CEO -PROCREDIT
BANK



të interesuara në çdo mënyrë të kontribuojnë vazhdimisht në zhvillimin ekonomik të vendit.

Sektori bankar i Kosovës karakterizohet me nivel të lartë të kapitalizimit i cili është mbi 19%, nivel të kënaqshëm të mbulueshmërisë së kredive jo performuese prej 115% dhe profit neto që për vitin 2015 pritet të jetë mbi EUR 60 milion.

Të gjithë këta indikatorë flasin në favor të një sistemi të fuqishëm bankar i cili nën mbikëqyrjen vigjilente të Bankës Qendrore të Kosovës i tejkaloi dhe vazhdon t'i përballoj me sukses kërkesat në rritje.

Gjithashtu arritjet e sektorit vijnë edhe nga përkushtimi i investitorëve që kanë për të investuar në kapacitete humane dhe infrastrukturë moderne që të bëjnë sektorin të qëndrueshëm dhe rentabil, prandaj besoj që sektori bankar mund të shërbej si model për zhvillimet e sektorëve tjerë të ekonomisë.

Sektori i fuqishëm bankar është parakusht për investime të mëtutjeshme, për përkrahjen dhe rritjen e kredihënies e cila në fund të vitit 2015 pritet të jetë mbi EUR 2 bilion por edhe të vazhdoj të dëshmoj siguri dhe kredibilitet për të gjithë depozituesit vlera e të cilëve në fund të vitit 2015 pritet të arrij në mbi EUR 2.7 bilion.

Në fund, dëshiroj të përgëzoj stafin e Shoqatës së Bankave, botues të kësaj reviste, që në vazhdimësi dialogon me akterët kryesorë të industrisë financiare në mënyrë që të propozoj avancim të sistemit.

BANKAT PROFITABILE: POZITIVE APO NEGATIVE?

“A duhet profitabiliteti i sektorit bankar të perceptohet si një zhvillim pozitiv për ekonominë e Kosovës? Cilat janë supozimet që shpesh çojnë deri te një perceptim negativ dhe reagim negativ ndaj kësaj storje suksesi në Kosovë, përkatësisht performanca e mirë e sektorit bankar, apo duhet kjo të konsiderohet si model i suksesshëm i cili mund të përdoret si një model shembull për sektorët e tjerë të ekonomisë së Kosovës? Cilat janë efektet që një sektor bankar i shëndetshëm dhe fitimprurës mund të ketë në ekonomi vs. efektet shkatërruese që një sektor i brishtë financiar nën presion mund të kishte? ”

Shoqëria, jo vetëm në Republikën e Kosovës, por në të gjithë botën, po sfidohet në shumë fusha të jetës. Politika, ekonomia, religjioni, arsimiti, shëndetësia, mjedisi, privatësia dhe shumë tema të tjera me interes shqetësojnë shoqërinë tonë kohët e fundit më shumë se kurrë më parë. Në këtë kontekst, ka një tendencë për të vënë në dyshim gjithçka dhe çdonjërin. Sektori bankar, gjithashtu, merr pjesën e tij të vështirimeve kritike nga mediat dhe publiku i gjerë, dhe në pjesën më të madhe të rasteve, pa ndonjë bazë të fortë dhe pa argumente të mbështetura. Këto mendime kritike shpesh krijohen për shkak të mungesës së informacionit, por edhe për shkak të një konfuzioni të përgjithshëm në shoqëri për rolin e bankave komerciale, si institucione private fitimprurëse dhe në të njëjtën kohë si ofrues të shërbimeve shumë esenciale financiare, që janë shpesh herë një domosdoshmëri në jetën e qytetarëve, si dhe në operacionet e bizneseve dhe institucioneve të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare.

Politikanët gjithashtu, shpeshherë i bashkëngjiten këtij diskutimi, ku, më shpesh sesa jo, ata zgjedhin për të mbështetur nocione populiste, të cilat kritikojnë sektorin bankar, ku ata shpresojnë se kjo do të përkthehet në vota gjatë periudhave

Z. PETRIT BALIJA

DREJTOR EKZEKUTIV

SHOQATA E
BANKAVE TË
KOSOVËS



zgjedhore. Një prej këtyre temave të vështruara në prizmin e kritikës në Kosovë, gjatë dy viteve të fundit, është profitabiliteti i sektorit bankar. Publiku i gjerë, politikanët dhe media shpesh kritikojnë sektorin bankar për “fitimin e tyre të lartë të pajustificueshëm”, siç ata pretendojnë që është fitimi në sektorin bankar të Kosovës. Pyetjet që duhet të parashtrrojmë, në këtë rast, janë: A duhet profitabiliteti i sektorit bankar të perceptohet si një zhvillim pozitiv për ekonominë e Kosovës? Cilat janë supozimet që shpesh çojnë në një perceptim negativ dhe reagim negativ ndaj kësaj storje suksesi në Kosovë, përkatësisht performanca e mirë e sektorit bankar, apo duhet kjo të konsiderohet si model i suksesshëm i cili mund të përdoret si një shembull model për sektorët e tjerë ekonomik të Kosovës? Cilat janë efektet që një sektor bankar i shëndetshëm dhe fitimprurës mund të ketë në ekonomi vs. efekteve shkatërruese që një sektor i brishtë financiar nën presion mund të kishte?

Sektori bankar në Kosovë është një sektor relativisht i ri pasi që ka pasur vetëm 15 vite zhvillimi që nga themelimi i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës në Nëntor të vitit 1999. Në këtë periudhë të shkurtër kohe, ky sektor është rritur në gjithsej 10 institucione bankare¹ që

¹ ProCredit Bank Kosovo, Raiffeisen Bank Kosovo, TEB Bank, NLB Bank, Banka Ekonomike, Banka Per Biznes, Banka Kombetare Tregtare, IsBank, Ziraat Bank, Komercialna Banka

veprojnë në Kosovë, me asete totale në vlerë prej rreth 3.2 miliardë Euro, që paraqet 69.1% të totalit të aseteve² të sektorit financiar të Kosovës. Sektori bankar ka rritur vazhdimisht financimin për bizneset dhe konsumatorët individualë ku portofolio totale kreditore është rritur në mbi 2 miliard Euro. Shumica e bankave në Kosovë janë themeluar si banka të huaja kryesisht si filiale, por edhe si degë bankash, ndërsa ka vetëm dy banka që janë themeluar si banka vendore. Në këtë konsistencë, sektori bankar përbën pjesën më të madhe të totalit të aseteve të sektorit financiar të Kosovës, i cili është një tregues i ndikimit të tij të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Kjo mund të konsiderohet si një avantazh për sektorin bankar në Kosovë, sepse, Përveç investimeve të tyre kapitale, bankat e huaja gjithashtu sjellin me vete shumë njohuri teknike dhe përvojë në tregun e Kosovës duke promovuar praktikën më të mira ndërkombëtare.

në 6.8% dhe të gjitha bankat janë të kapitalizuara mirë dhe likuide me një raport të kredive ndaj depozitave në nivel të sektorit në 75%. Për më tepër, statistikën e Bankës Qendrore të Kosovës tregojnë se të hyrat nga interesi kanë mbetur të qëndrueshme gjatë viteve, si dhe të hyrat nga jo-interesi (i cili përfshin tarifën e shërbimeve). Këto statistika janë shumë të rëndësishme për t'iu përgjigjur atyre që kanë përceptimin e gabuar që sektori bankar është duke fituar më shumë nga normat e larta të interesit ose nga tarifën e larta të shërbimit. Është e mundur që disa tarifa specifike të shërbimeve bankare në disa banka mund të jenë rritur në përputhje me strategjitë e tyre të zhvillimit, megjithatë, siç u përmend më lart, të hyrat nga jo-interesi, në nivel të sektorit, kanë mbetur në nivele pothuajse të njëjta gjatë viteve siç mund të shihet në Tabelën nr.1 të paraqitur më poshtë.

Tabela 1. Pasqyra e të ardhurave: Të hyrat nga interesi dhe jo-interesi

PASQYRA E TË ARDHURAVE						
	Milion Euro*					
Përshkrim	2010	2011	2012	2013	2014	Korrik-15
Të hyrat nga interesi	175.8	195.1	200.5	198.2	195.9	110.2
Të hyrat nga jo-interesi	41.4	45.0	46.6	49.6	47.8	29.0

Sektori bankar në Kosovë ka qenë gjithnjë rentabil, por në dy vitet e fundit 2014 dhe 2015 ai ka tejkaluar të gjitha nivelet e mëparshme të fitimit të raportuar me fitim neto prej 60.1 milion Euro në 2014 dhe 69.3 milion Euro fitim neto të raportuar në fund të Shtatorit 2015. Mund të supozohet, që arsyet që mundësojnë këtë fitim janë me rëndësi për të adresuar pyetjet kryesore të paraqitura në këtë artikull. Çfarë e bën sektorin bankar aq fitimprurës në këto dy vitet e fundit? A janë duke i rritur normat e interesit bankat dhe duke fituar më shumë të hyra nga interesi? A janë duke rritur bankat tarifën e tyre të shërbimit dhe duke fituar më shumë të ardhurat nga jo-interesi? Këto janë disa nga pyetjet që lidhen me pyetjet kryesore të këtij artikulli. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të thuhet se ky fitim vjen në një kohë kur norma mesatare e interesit të kredisë ka qenë në nivelin më të ulët me rreth 7.9% në normën mesatare efektive të interesit në kredi, të raportuar në fund të Shtatorit 2015. Kjo tregon një rënie prej rreth 45 përqind në normat mesatare të interesit të kredisë në krahasim me vitin 2010, kur norma mesatare efektive e interesit për kredi ishte rreth 14.3%. Për më tepër, kreditë jo performuese mbeten në nivelin e tyre më të ulët

Pra, çfarë mund të jetë shkak i rritjes së përfitimit në dy vitet e fundit? Përgjigja qëndron me koston e financimit dhe të nivelit të provizionimit. Kostoja e financimit ka rënë ndjeshëm për shkak të normave të ulëta të interesit të depozitave dhe të provizionimit të ulët si rezultat i kthimit të kredive në vonesë dhe normave të ulëta të përgjithshme të kredive jo-përformuese në këtë sektor.

Një pyetje tjetër që shpesh parashtrahet nga mediat dhe analistët ekonomik është në lidhje me normat e interesit të depozitave dhe diferencën në mes të normave mesatare të interesit të kredive dhe normave mesatare të interesit të depozitave. Pse janë normat e depozitave kaq të ulëta? Pse është marzha e interesit kaq e lartë? Pse nuk munden bankat të paguajnë norma më të larta interesi për të ndihmuar kursimtarët të fitojnë më shumë në kursimet e tyre? Përgjigjet e këtyre pyetjeve qëndrojnë me pozicionin e likuiditetit të sektorit bankar, përkatësisht relacioni i kredive ndaj depozitave. Ky raport ka qëndruar rreth 75%, që do të thotë se sektori bankar është relativisht likuid dhe nuk ka nevojë për më shumë depozita për të financuar ndonjë kredi për shkak se kërkesa për kredi nuk është mjaft e lartë për të nxitur një

² Raport BQK, Qershor 2015

nevojë për më shumë depozita. Në një situatë të tillë, sektori bankar nuk do të nxiste klientët e tij për të depozituar më shumë fonde; megjithatë klientët bankar kanë nevojë të vazhdueshme për të depozituar fonde prandaj bankat duhet të ulin normat e interesit të depozitave për të kundër-balancuar këtë kosto të financimit. Vlen të përmendet se normat e ulëta të interesit të depozitave nuk janë një trend vetëm në Kosovë por edhe në rajon dhe në Eurozonë, ku disa prej bankave në këto vende tani kanë aplikuar norma negative të interesit në depozita për klientët e tyre. Në fakt, disa nga bankat e Kosovës, detyrohen të depozitojnë këtë likuiditet të tepërt me norma negative të interesit në këto banka të huaja. Megjithatë, marzha e interesit është në rënie në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve të fundit, siç tregohet në Tabelën 2 më poshtë.

Tabela 2. Marzha e normave të interesit

Përshkrim	2010	2011	2012	2013	2014	Korrik-15
Norma efektive e interesit për depozita	3.4%	3.6%	3.7%	2.4%	1.1%	0.8%
Norma efektive e interesit për kredi	14.3%	13.9%	12.9%	11.1%	9.2%	8.1%
Marzha e interesit	10.9%	10.2%	9.1%	8.7%	8.1%	7.2%

Për sa i përket efekteve që një sektor bankar profitabil ka në ekonomi, unë do të theksoj vetëm disa nga efektet kryesore pasi që për pjesën më të madhe përfitimet janë të vetëkuptueshme. Një sektor bankar profitabil rrit stabilitetin e përgjithshëm të sistemit financiar dhe redukton mundësinë e një krize të sektorit financiar, që do të thotë se ekonomia nuk do të vuaj nga efektet negative të një sektori financiar në krizë dhe qeveria nuk do të duhet të shpëtoj ndonjë institucion bankar me taksat e tatimpaguesve, siç e kemi parë të jetë rasti në disa vende të tjera. Përveç kësaj, një sektor profitabil bankar do të jetë në gjendje të rrit kapacitetet e tij për të zgjeruar portofolin e tij të kreditimit për të financuar më shumë biznese dhe për të rritur qasjen në financa përmes shërbimeve më të avancuara bankare në të gjitha pjesët e vendit. Kjo do të thotë që bizneset mund të zgjerohen dhe të kontribuojnë në uljen e papunësisë dhe në rritjen e përgjithshme ekonomike. Për më tepër, një sektor profitabil bankar mund të investojë në shërbime këshilluese që mbështesin bizneset në çështjet e tyre financiare dhe do të ndihmonin ata me shërbime të avancuara financiare. Një sektor profitabil bankar mund të përballojë të

Në bazë të informacionit të dhënë më sipër, është e qartë se profitabiliteti i sektorit bankar nuk rrjedh nga një rritje në normat e interesit të kredive ose nga rritja e tarifave të shërbimeve, ashtu siç shpesh supozohet në mënyrë të gabuar. Në fakt, bankat nuk kanë zgjidhje tjetër, përpos të qëndrojnë profitabile, në këto rrethana, për shkak se janë pikërisht masat për afarizëm të përgjegjshëm bankar që kanë sjellur një rritje të fitimit. Për bankat të mos jenë fitimprurëse, do të thotë se ato do të duhet të braktisin masat e afarizmit të përgjegjshëm bankar dhe ndoshta të rrisin kreditë jo performuese dhe provizionimin dhe të rrisin koston e financimit apo normat e interesit të depozitave, që do të çonte në një nivel shumë të rrezikshëm të likuiditetit. Rritja e normave të interesit në depozita mund të ndodhë vetëm nëse kërkesa për kredi rritet, me ç'rast, kërkesa për depozita rritet dhe bankat do të fillojnë nxitjen e klientëve të tyre drejt më shumë depozitave.

investoj në burimet e tyre njerëzore, teknologjitë dhe zhvillimet e produkteve me të cilat klientët do të përfitonin nga rritja e nivelit të shërbimit dhe shërbimeve më të përshtatshme bankare. Më e rëndësishmja, një sektor fitimprurës bankar siguron stabilitet për të gjithë depozituesit dhe investitorët e sektorit bankar.

Prandaj, është tepër e paarsyeshme dhe e pamatur të thuhet se "fitimet e sektorit bankar janë të pajustificueshme", kur konsideron të gjitha argumentet e elaboruara më lartë të cilat tregojnë qartë përfitimet që ndërliken me një sektor fitimprurës dhe të qëndrueshëm bankar që duhet të shërbejë si një sektor model për sektorët e tjerë të ekonomisë të cilët gjithashtu duhet të veprojnë në mënyrë konkurruese për të arritur një nivel të lartë të performancës. Vetëm atëherë kur shumica e sektorëve të tjerë të ekonomisë rrisin performancën e tyre në nivel të sektorit bankar, Kosova do të ketë një ekonomi konkurruese që do të përmbushë nevojat e popullit të Kosovës dhe të sigurojë një të ardhme të begatë përballë dhe përkrahë me ekonomitë e tjera konkurruese të Bashkimit Europian.

CILA ËSHTË RËNDËSIA E RRRITJES SË FINANÇIMIT PËR ENERGJI EFIÇIENTE DHE ENERGJI TË RIPËRTËRISHME?

Për të arritur efiçencen duhet të bëhen investime dhe ndryshime thelbësore. Fillimisht është e rëndësishme të fillohet nga vetëdijësimi se përdorimi efiçient i energjisë elektrike është një ndër hapat kryesorë që sjellin kursim sot, për një përfitim nesër. Kurse hapat tjetër ndërlihen me investime direkte në objekte si private ashtu edhe në biznese, mjete të transportit dhe në makineri punuese.

Shpenzimi i lartë i energjisë në Kosovë është një ndër arsytet përse bizneset dhe ekonomitë tona familjare kanë shpenzime dhe fatura të larta të energjisë elektrike. Duke qenë se ekonomia në Kosovë sa shkon e rritet, ndjehet edhe nevoja për kursime në shpenzimin e energjisë.

Në anën tjetër, me standardet dhe teknologjinë aktuale të prodhimit të energjisë elektrike të përdorur, Kosova ka nivelin më të lartë në Evropë të lirimit të CO₂ (dyoksidit të karbonit) për kilovatët e shpenzuar. Si rrjedhojë çdo kilovat i kursyer i energjisë ndikon direkt në zvogëlimin e ndikimit negativë si në shëndetin e qytetarëve ashtu edhe në mjedis.

Zgjidhja adekuate për të ulur këtë ndikim negativ është përdorimi efiçient i energjisë, apo sigurimi i energjisë nga burime alternative të ripërtritshme dhe jo të dëmshme.

Që të kemi një vizion më të qartë të rrugës drejt kursimit të energjisë duhet fillimisht të dimë se cilët janë shpenzuesit më të mëdhenj të energjisë në ekonomitë familjare dhe në

Z. GËZIM TROPOJA

UDHËHEQËS
I NJËSISË SË
MJEDISIT

PROCREDIT BANK



biznese. Si për ekonomitë familjare ashtu edhe për bizneset, shpenzimet më të mëdha mund të vijnë nga ngrohja/ftohja e objektit, sistemi i ndriçimit, kurse në veçanti për bizneset rol shumë të rëndësishëm luajnë edhe teknologjia dhe makineritë e punës.

Për të arritur efiçencen duhet të bëhen investime dhe ndryshime thelbësore. Fillimisht është e rëndësishme të fillohet nga vetëdijësimi se përdorimi efiçient i energjisë elektrike është një ndër hapat kryesorë që sjellin kursim sot, për një përfitim nesër. Kurse hapat tjetër ndërlihen me investime direkte në objekte si private ashtu edhe në biznese, mjete të transportit dhe në makineri punuese.

Sa i përket çështjes së kursimit të energjisë, janë disa masa që mund t'i ndër marrin rreth kursimit të energjisë, duke filluar nga mirëmbajtja e kondicionerëve, që vlerësohet të jenë shpenzuesit më të mëdhenj, pasi që janë në funksion gjatë dimrit për ngrohje, ashtu edhe gjatë verës për freskim, zëvendësimi i frigoriferëve ose frizeve me ato më cilësore, sepse janë më të qëndrueshme dhe më ekonomike.

Nëse përdorni kondicionerët për ngrohje, mos e caktoni temperaturën më të lartë se 19°C. Nëse përdorni kondicionerët për freskim të ambientit gjatë verës, mos e caktoni temperaturën më ulët se 26°C - 28°C. Mbani të mbyllura dyert dhe dritaret derisa është i ndezur sistemi për ngrohje ose freskim. Bëni pastrimin e filtrave dhe kujdesuni që kondicioneri të ketë drenim të mirë të ujit.

Ju mund të ndërmerrni disa hapa të thjeshtë për të zvogëluar shpenzimet e ndriçimit dhe me këtë veprim do t'i ndihmoni vetes dhe rrethinës, në mënyrë që edhe të tjerët të kenë dritë. Mos i lini dritat ndezur në hapësirat të cilat nuk i shfrytëzoni. Në hapësirën e jashtme, nëse nuk është e domosdoshme, mos lini shumë drita të ndezura. Nëse përdorni më shumë drita, atëherë orientohuni në shfrytëzimin e dritave fluoreshente (të neonit), apo dritat e teknologjisë LED. Zëvendësoni dritat inkandeshente, të ngrohta, (poçet elektrikë të zakonshëm) me dritat flu-oreshente (të neonit), apo dritat e teknologjisë LED. Dritat fluoreshente (të neonit) shfrytëzojnë 75% më pak energji elektrike dhe qëndrojnë 10 herë më shumë se dritat e zakonshme inkandeshente, përderisa dritat LED janë deri në 50% me eficiencë se dritat fluoreshente. Po ashtu, sugjerohet sidomos për bizneset, që në hapësira të caktuara të vendosen sensorë, që aktivizohen dhe ndriçojnë vetëm kur ka lëvizje. Varësisht nga përdorimi i dritave, ndriçimi në amvisëri mbulon rreth 12% të shpenzimeve të përgjithshme vjetore.

Për biznese të ndryshme shpenzues kryesore mund të jenë ftohësit dhe ngrirësit. Për këtë, sugjerohet që nëse keni vendosur të blini frigorifer apo ngrirës të ri, atëherë orientohuni në produkte më cilësore të klasës "A", sepse janë më të qëndrueshme dhe më ekonomike.

Kur flasim për biznese me rendësi është teknologjia dhe makineritë që këto biznese i përdorin. Zbatimi dhe aplikimi i makinerive të teknologjisë së fjalës së fundit ndikojnë në vlerat dhe cilësinë e prodhimit dhe në nivelin e ofrimit të shërbimeve për konsumatorët. Praktika dhe të dhënat tregojnë se përmes aplikimit të teknologjive të reja, ndërmarrjet

kanë arritur që të rrisin produktivitetin dhe në të njëjtën kohë kanë ulur koston e prodhimit, përkatësisht kanë arritur maksimizimin e fitimit, që në kohërat moderne është qëllimi i çdo ndërmarrësi. Gjatë procesit të prodhimit, një nga kontribuesit kryesorë në shpenzime është energjia e shfrytëzuar. Teknologjitë e reja mundësojnë kursimin direkt të energjisë dhe shpejtimin e procesit të punës, që gjithashtu reflektohet në kursim të energjisë. I tërë ky kursim i energjisë për bizneset paraqet kursim financiar.

Shpenzimi i lartë i energjisë në Kosovë është një ndër arsye të përse bizneset dhe ekonomitë tona familjare kanë shpenzime dhe fatura të larta të energjisë elektrike. Duke qenë se ekonomia në Kosovë sa shkon e rritet, ndjehet edhe nevoja për kursime në shpenzimin e energjisë.

Përveç kësaj, zëvendësimi i punës së krahut me makineri të fjalës së fundit, ka bërë që ndërmarrësit e rinj dhe të vjetër t'i plotësojnë apo arrijnë statet që i parasheh koncepti i eficiencës (ka të bëjë me nxjerrjen e një dobie ose kënaqësie maksimale të mundshme nga përdorimi i burimeve ekonomike), dhe i mirëqenies (i referohet kënaqësisë që një individ apo shoqëria nxjerrin nga konsumi i pasurisë). Kurse për sigurimin e energjisë nga burimet e ripërtrishme, nevojiten investime në teknologji të cilat mundësojnë konvertimin e energjisë natyrore në energji të shfrytëzueshme (elektrike apo termike). Investimet e tilla janë investimet në panele diellore, hidrocentrale, mullinj të erës apo investime në shfrytëzimin e energjisë nga biomasa (mbetjet organike).

Rëndësia e investimeve në efikasitet të energjisë apo në energji të ripërtitshme mund të vërehet edhe nga vet standardet e përcaktuara nga BE. Standardet e BE-së kërkojnë që kursimet në energji dhe mbrojtje të ambientit të respektohen në çdo shtet që është pjesë ose që synon të bëhet pjesë e kësaj familjeje. Objektivat e planit të BE-së quhen 20-20-20 për sektorin e energjisë, gjë që kërkon nga vendet anëtare deri në vitin 2020, të ulin emetimet e gazrave serrë për 20%, të rritet proporcioni i energjisë së ripërtitshme të konsumit fundor në 20%, si dhe të përmirësohet efikasiteti i energjisë për 20%.

Bashkimi Evropian, përkatësisht Komisioni Evropian, në raport me këtë fushë ndanë fonde dhe donacione të ndryshme, jo vetëm për institucionet shtetërore, por edhe për kompanitë që investojnë në fushën e efikasitetit në energji. Që një gjë e tillë të realizohet nga KE, është shumë e mundur në qoftë se ekziston një projekt i qartë dhe mirë i detajuar.

Përveç kësaj, bankat afariste në Kosovë, kohëve të fundit kanë filluar që t'i specifikojnë kreditë e tyre për fusha të rëndësishme, ku hyn edhe fusha që ka të bëjë me efikasitetin e energjisë. Me anë të kredisë së quajtur "eko kredi", ProCredit Bank iu bën të mundur afaristëve kosovarë investimin në fushën e kursimit të energjisë, apo në energji të ripërtitshme. Qëllimi i kësaj kredie është promovimi i investimeve në biznese që zvogëlon shpenzimin e lartë të energjisë elektrike.

Komponentë kyç në misionin e bankën tonë është të sigurohemi që zhvillimi ekonomik të cilin ne e përkrahim të krijoj një ambient të qëndrueshëm sa i përket mjedisit dhe shoqërisë. Ofrojmë produkte kreditore për investime në efikasitet të energjisë, energji të ripërtitshme dhe aktivitete të ndërlidhura me mbrojtje të mjedisit.

Përfitimet që vijnë nga investimet në përdorimin efiçent të energjisë me anë të kredisë janë kursimi i parave për çdo muaj, fitimi i avantazhit konkurrues në treg, përmirësimi i reputacionit në treg si dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme, kontributi në mbrojtjen e mjedisit.

Objektivat e planit të BE-së quhen 20-20-20 për sektorin e energjisë, gjë që kërkon nga vendet anëtare deri në vitin 2020, të ulin emetimet e gazrave serrë për 20%, të rritet proporcioni i energjisë së ripërtitshme të konsumit fundor në 20%, si dhe të përmirësohet efikasiteti i energjisë për 20%.



MBËSHTETJA EMERGJENTE ME LIKUIDITET DHE MANUALI I MBIKËQYRJES SË BAZUAR NË RREZIK PËR BANKA – HAPA DOMETHËNËS NË STABILITETIN E SEKTORIT BANKAR

Koncepti i stabilitetit bankar përbën një qasje komplekse dhe kërkon angazhim shumëdimensional. Qëllimi parësor i çdo rregullatori është pasja e një sistemi bankar stabil duke ngërthyer në vete një zhvillim të qëndrueshëm dhe stabil të këtij sektori. Dialogu mbikëqyrës dhe qasja e angazhimit në preventivë kanë rol domethënës në identifikimin dhe parandalimin e destabilizimit të sektorit bankar. Që të jemi korrekt, anticipimi me zhvillimet e paqëndrueshme në sektorin bankar është detyrë e rëndësishme kyçe të rregullatorit.

Meqenëse legjislacioni bankar adreson kryesisht mbikëqyrjen e bankave kur ato janë në pozita financiare stabile, Rregullorja për Mbështetje Emergjente për Likuiditet e aprovuar nga BQK në shtator 2015, adreson përgjegjësitë, veprimet dhe hapat kur bankat kanë vështirësi të likuiditetit, kur janë jolikuide por solvente. Marrë parasysh ndjeshmërinë e fushës që adreson, kjo rregullore është diskutuar në mënyrë intensive me Fondin Monetar Ndërkombëtar e po ashtu është diskutuar edhe me bankat në Kosovë. Fakti që përpilimi i kësaj rregulloreje është bërë në kohën kur bankat nuk kanë vështirësi financiare, ka mundësuar kohën e mjaftueshme në dispozicion për përpilimin e saj.

Pasi që aspekti i matjes së zbatueshmërisë është një parametër kyç, para se kjo rregullore të aprovohet është testuar edhe gjatë misionit të Bankës Botërore në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës lidhur me simulimin e krizës. Vlerësimet e misionit në fjalë kanë qenë shumë pozitive duke përfshirë edhe disa rekomandime që janë adresuar përshtatshëm.

Më specifikisht, kjo rregullore përcakton kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen nga bankat të cilat kërkojnë mbështetje emergjente për likuiditet, llojet e pranueshme të kolateralit, kushtet dhe procesin e vlerësimit të një kërkesë

Z. MENTOR GECI

DREJTOR

DEPARTAMENTI
MBIKËQYRJES
BANKARE

BANKA QENDRORE
E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS



të tillë me qëllim të zbatimit të nenit 14 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) i cili autorizon BQK-në, që në rrethana të jashtëzakonshme dhe sipas gjykimit të saj të veprojë si kreditor i instancës së fundit për një bankë të licencuar, si dhe në pajtim me nenin 12, paragrafi 1 të Ligjit mbi BQK-në që autorizon BQK-në të ndryshojë përkohësisht rezervat minimale të bankave të caktuara.

Në rastet kur BQK aplikon instrumentin e ndryshimit të përkohshëm të normës së rezervës minimale, bankave nuk ju kërkohet që vendosin kolateralin në BQK, mirëpo çdo aplikim i kredisë si instrument lidhur me mbështetjen emergjente për likuiditet, atëherë llojet e pranueshme të kolateralit që pranohen nga BQK me këtë rast janë: letrat me vlerë (llojet e caktuara), ari, si dhe ndonjë kolateral tjetër i pranueshëm nga BQK. Rregullorja po ashtu, parasheh edhe mundësinë e ripërtëritjes së kërkesës për mbështetje emergjente me likuiditet.

Krahas kërkesave që dalin nga Rregullorja për Mbështetje Emergjente për Likuiditet, BQK tashmë ka përpiluar edhe Politikën për Mbështetje Emergjente për Likuiditet. Politika për Mbështetje Emergjente për Likuiditet adreson kërkesat lidhur me llojet dhe kushtet e kolateralit si dhe atë të fondeve në dispozicion për mbështetje emergjente për likuiditet. Marrë në përgjithësi, rregullorja në fjalë paraqet një avancim të mëtutjeshëm nivelit të sigurisë financiare të bankare.

Pas një testimi më se dy vjeçar, në gusht 2015 BQK ka aprovuar Manualin e Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Banka. Përkrahur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Thesari Amerikan, Manuali i Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Banka paraqet një qasje të re të mbikëqyrjes së bankave me fokus kryesor në rreziqet ndaj të cilave ekspozohen bankat si: rreziku kreditor, likuiditetit, tregut dhe rreziku operacional gërshetuar me sasinë e rrezikut të vetvetishëm, kualitetin e menaxhimit të rrezikut, nivelin e përgjithshëm të rrezikut si dhe drejtimin e rrezikut. Marrë në përgjithësi, Manuali është ndarë në tri pjesë kryesore dhe atë në procesin e para-ekzaminimit, gjatë si dhe procesin e pas-ekzaminimit. Përveç tjerash Manuali adreson edhe çështjen e mbikëqyrjes së konsoliduar si dhe frekuencën e ekzaminimit të bankave varësisht nga rangimi.

Në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, BQK-ja ka rishikuar politikën, procedurat dhe praktikën e saj mbikëqyrëse në mënyrë që të sigurojë një kornizë mbikëqyrëse dinamike, efikase, të strukturuar dhe të orientuar në rrezik. Mbikëqyrja e bazuar në rrezik është një proces i strukturuar, fleksibil dhe progresiv i disenjuar që të identifikojë, vlerësojë, matë, monitorojë dhe kontrollojë/zvogëlojë faktorët kryesorë të rrezikut të cilëve u janë ekspozuar bankat individuale dhe e gjithë industria financiare.

Duke përdorur qasjen e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, vlerësohen politikën për vlerësimin e rrezikut dhe praktikën e përdorura nga bankat për të kontrolluar/zvogëluar rrezikun. Fokusi i vëmendjes mbikëqyrëse sipas mbikëqyrjes së bazuar në rrezik është në fushat e rrezikut të cilat paraqesin rrezik më të lartë për sigurinë dhe mirëqenien e bankave. Mbikëqyrja e bazuar në rrezik gjithashtu mbështet BQK-në në arritjen e objektivave të saj rregullatore, duke marrë parasysh nevojën për të angazhuar burimet e saj në mënyrën më efikase dhe efektive.

Mbikëqyrja e bazuar në rrezik mundëson vlerësimin e nivelit të rrezikut, cilësinë e menaxhimit të rrezikut dhe drejtimin e rrezikut (rritje, rënie dhe stabile). Kjo rezulton me zhvillimin e profilit të rrezikut për bankën. Manuali i Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Banka lehtëson trajtimin e mbikëqyrjes së vazhdueshme të bankave nga Departamenti i Mbikëqyrës Bankare në kuadër të BQK-së dhe do të shfrytëzohet nga stafi si manual referues dhe udhëzues pune.

Sipas manualit në fjalë, gjithçka fillon me të kuptuarit (hapi 1) e institucionit që përfshin

profilin e institucionit, bazuar në të cilin më pastaj vazhdohet me vlerësimin rreziqeve të institucionit (hapi 2), që ngërthen në vete dy komponentë, matricën e rrezikut dhe përshkrimin e vlerësimit të rrezikut. Pas vlerësimit të rreziqeve, përfshirë sasinë, cilësinë e menaxhimit të tij si dhe drejtimin (trendin), bëhet planifikimi dhe caktimi i aktiviteteve mbikëqyrëse që nënkupton planin e detajuar mbikëqyrës (hapi 3). Pasi të jetë përpiluar plani, vazhdohet me përkufizimin e aktiviteteve të ekzaminimit (hapi 4) duke specifikuar procedurat e ekzaminimit që mund të jenë standarde (ekzaminim më i detajuar) dhe minimale (ekzaminim më pak i detajuar). Kjo, konform profilit të rrezikut për institucionin e caktuar. Hapi i 5-të ka të bëjë me ekzaminimin që kryhet në vend bazuar në rreziqet e vlerësuara. Pasi që ekzaminimi të jetë kryer dhe raporti të jetë finalizuar dhe dërguar, mbetet të bëhet përcjellja përmes mbikëqyrjes indirekte (off-site) e me këtë edhe përditësimi i rregullt i profilit.

Një institucion financiar i angazhuar në një aktivitet të vetëm, është relativisht i hapur për tu mbikëqyrur. Megjithatë institucionet financiare zgjerojnë, diversifikojnë, bëjnë investime dhe formojnë filiale. Ato gjithashtu formojnë partneritete dhe marrin kompani të tjera. Ato zgjerojnë operacione në kompani tjera. Me kaq shumë ndryshime, mbikëqyrësve ju nevojitet të mbledhin informacionet e nevojshme për të fituar një pamje të duhur të strukturës komplekse të biznesit. Pasi që bankat ndërmarrin një shumëllojshmëri të aktiviteteve të ndryshme të biznesit në lloje të ndryshme të entiteteve operative dhe nëpër shumë vende, është e rëndësishme që një grup bankar të mbikëqyrët në bazë të konsoliduar duke qenë se rreziqet mund të dalin nga çdo pjesë e grupit.

Fushëveprimi i mbikëqyrjes së konsoliduar është menduar të jetë gjithëpërfshirës dhe duhet të mbulojë entitetet jo-bankare brenda grupit, si dhe entitetet që janë përtej fushëveprimit të konsolidimit të kontabilitetit. Përveç kësaj, ajo duhet të mbulojë kompaninë mëmë të bankës, si dhe filialet e kompanisë mëmë. Rrjedhimisht, adresimi konkret i mbikëqyrjes së konsoliduar paraqet një atribut tjetër të rëndësishme së veçantë të manualit.

Si përfundim, pasi që manuali tenton të adresojë identifikimin e sfidave të sektorit bankar, detyrë e domosdoshme është përditësimi i tij në mënyrë periodike. Kjo do të mundësojë që manuali në mënyrë të vazhdueshme të pasurohet me parimet bashkëkohore mbikëqyrëse në korrelacion me sfidat e zhvillimit të sektorit bankar në Kosovë.

TEKNOLOGJIA DHE SISTEMI BANKAR

Çdo vendim për të investuar në teknologji nga aspekti financiarë është i lartë, ndërsa kthimi jo gjithmonë është i garantuar, veçanërisht nëse ky investim në teknologji si premisë kryesore për kthim të investimit e ka ndryshimin në preferencat e konsumatorëve.

Analizat e ndikimit të teknologjisë në sistemin bankar nuk janë dukuri e re, por ndikimi i vërtet i tyre në jetën e përditshme të konsumatorëve është më i shprehur vitet e fundit.

Në përgjithësi kur flitet për teknologjinë informative në sistemin bankar , përmenden dy mënyra kryesore se si manifestohet ky ndikim :

1) Teknologjia informative në përgjithësi ndikon në reduktimin e kostove të lidhura me menaxhimin e informatave dhe proceseve duke i automatizuar ato :

- Kostot për transaksion (e-banking) krahasuar me mënyrën manuale të transaksioneve janë shumëfish më të ulëta , por në te njëjtën kohë kostot e investimeve në teknologji dhe staf të kualifikuar rriten ndjeshëm
- Investimet në teknologji mundësojnë krijimin e bazave më të mëdha dhe të organizuara të dhënave që mundësojnë analiza më të detajuara për konsumatorët dhe e rrisin vlerën e të dhënave që posedon banka.
- Menaxhimi më i mirë i rreziqeve të ndryshme bankare

2) E ndryshojnë mënyrën e qasjes së klientëve të bankave në shërbimet dhe produktet:



**Z. REZAK
FETAJ**

MENAXHERË I
LARTË

PROCREDIT BANK

- Krijojnë alternativa më të lehta të qasjes së klientëve te produktet dhe shërbimet bankare, respektivisht krijimin e zonave 24/7
- Mundësohet ofrimi i shërbimeve në zona ku më herët ka qenë e pamundur të kryhen operacione bankare sepse tani lokacioni fizik zëvendësohet me lokacion virtual në internet
- E rrisin konkurrencën në sektorin bankar sepse konsumatorët më të sofistikuar janë në gjendje të krahasojnë më mirë çmimet dhe kualitetin e shërbimeve dhe nuk kanë lojalitet pa rezervë ndaj bankës së tyre.
- E rrisin konkurrencën duke shtuar lojtarë jo bankarë në ofrimin e shërbimeve financiare

Ndryshimet e lartpërmendura krijojnë sfida të shumta për sistemin bankarë dhe nevojë që të ndryshohet profili dhe modeli i biznesit të tyre , ndryshimet këto që asnjëherë nuk janë të lehta por janë të domosdoshme. Nëse i shtojmë një dozë dramatizimi dhe analogjie mund të themi se sfida me të cilën ballafaqohen bankierët i ngjajnë dilemës me të cilin janë përballur mbathësit e kuajve në kohën e kalimit në transportin me vetura : mund të zgjedhin të jenë mbathës më të mirë të kuajve apo te investojnë për t'u aftësuar në profesionin e automekanikut.

Sidoqoftë , rreziqet të cilët lindin nga përqaftimi dhe implementimi i teknologjive të reja janë po aq të mëdha sa edhe qëndrimi konservatorë ndaj tyre. Për industrinë bankare e cila në parim karakterizohet me planifikime të detajuara , kujdesi i theksuar në lidhje me përqaftimin dhe implementimin e teknologjive të reja është edhe më i shprehur dhe me shumë arsye.

Çdo vendim për të investuar në teknologji nga aspekti financiarë është i lartë, ndërsa kthimi jo gjithmonë është i garantuar , veçanërisht nëse ky investim në teknologji si premisë kryesore për kthim të investimit e ka ndryshimin në preferencat e konsumatorëve. Por , është fakt i pamohueshëm se këto preferenca ndryshojnë dhe në vete shkaktojnë revolucione të vërteta në sektorët e ndryshëm. Në të kaluarën një ndryshim i tillë ka qenë në sektorin e transportit , respektivisht kalimi nga format tradicionale të transportit në transport me mjete mekanike apo vetura dhe kalimi nga telefonat klasik në telefonat e mençur.

Ndryshimi në preferencat e konsumatorëve është parashikim në të cilin edhe kompanitë me aftësi më të mira planifikuese dhe liderët në teknologji informative jo gjithmonë janë të sigurt. Për këtë mjafton të kujtojmë ngritjen dhe rënien dramatike të pjesëmarrjes në treg të Nokias apo rritjes dhe uljes të shumë ndërmarrjeve globale nga industria e teknologjisë informative.

Shumë shpesh suksesin e një investimi në teknologji e përcakton edhe koha e duhur e implementimit të saj, por parashtrohet pyetja: cila është ajo kohë e duhur ?. Në këtë kuptim çdo lider i biznesit e pyet vetën a ka ardhur ajo pikë e ndryshimit (Inflection Point). Gabimi për të identifikuar këtë pikë të ndryshimit mund të shkaktoj probleme të shumta në funksionimin normal të ndërmarrjeve.

Ne këtë kontekst, nëse kjo pikë ndryshimi ka arritur , opsioni për të vendosur pro investimit ose kundër saj në teknologji është vetëm iluzion. Më tepër se vendim pro aktivë është vendim i vetëm racional.

Ndryshimet në sistemin bankar në Kosove nuk janë fenomene unike , përkundrazi janë fenomene të cilët i ndjekin ndryshimet në shtetet me zhvillim. Mos investimi në teknologji në fund të ditës reflektohet në klientin i cili nuk ka mundësi ta shijoj komfortin e shërbimeve moderne si dhe një institucion i cili punon në mënyrë efektive dhe është në gjendje të ofroj shërbime më të lira por edhe më të mira.

Nuk duhet harruar se interesi nominal i kredive ka pësuar një rënie të madhe në vitet e fundit. Sa për ilustrim, më poshtë po japim një tabelë e cila tregon rënien në përqindjen e interesit të kredive (normës efektive të interesit)

Sektori bankar	Dhjetor 2005	Dhjetor 2006	Dhjetor 2007	Dhjetor 2008	Dhjetor 2009	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015
Norma Efektive e interesit*	14.50%	14.70%	14.10%	13.80%	14.10%	14.30%	13.90%	12.90%	11.10%	9.20%	7.90%

* kosto totale e kredisë e paraqitur si normë vjetore e vlerës totale të kredisë.

Nëse krahasohet interesi vjetore i këtij viti (2015) me atë në vitin 2010, mund të konstatohet një rënie prej 6.4% në kreditë aktive që do të thotë EUR 6.4 milion më pak të hyra interesi në 100 milion EUR kredi. Një kalkulim i thjeshtë është i mjaftueshëm për të treguar se për sistemin bankar me shumën totale të kredive aktive prej afër EUR 2 bilion një ndryshim i tillë manifestohet në EUR 128 milion EUR më pak të hyra interesi për një vit, shifër që është më i lartë se çdo profit vjetorë i sistemit bankar në 5 vitet e fundit. Kuptohet këto ndryshime janë balancuar pjesërisht me uljen e normave të interesit të depozitat por assesi nuk e eliminojnë nevojën imediate për rishikim të gjitha proceseve bankare.

Ky ndryshim është faktori primar që determinon nevojën e gjetjes së formave të ndryshme të racionalizimit të shpenzimeve dhe gjetjes së mënyrave të reja të organizimit të punëve . Në këtë kuptim çdo gjë ndryshon përveç fjalëve të filozofit antikë Platonit se domosdoshmëria është nëna e shpikjes.

Kur përballemi me një ndryshim kaq të madh në botë përgjigja e vetme racionale duhet të jetë një adaptim po aq i shpejtë.

Sa për ilustrim në tabelën më poshtë po japim disa prerje kohore në rastin e Bankës ProCredit

në Kosovë për pjesëmarrjen e transaksioneve me e-banking në totalin e transaksioneve dhe atë prej momentit kur për here të parë është ofruar shërbimi e-banking (në vitin 2005) dhe transformimi i hatashëm në dy vitet e fundit dhe arritja e pjesëmarrjes në 82% të totalit të transaksioneve.

Natyrisht që për një ndryshim kaq të madh si parakusht ka qenë qasja në internet që është rritur shumëfish në krahasim me 2005 si dhe adaptimi i gjerë i telefonave të mençur

Në fakt , penetrimi i lartë i internetit në Kosovë dhe adaptimi i gjerë i telefonave të mençur janë dy indikatorë kryesorë që tregojnë se kemi të bëjmë me një konsumatorë të rafinuar , kërkesat dhe pritjet e të cilit kanë evoluar dhe janë të të njëjtit nivel sikur i çdo konsumatori në Evropë .

Ne këtë drejtim është mundësi e mirë por edhe obligim që sistemi bankar t'i ndjekë zhvillimet moderne bankare , zhvillime këto që shkojnë në drejtim të fuqizimit dhe pavarësisht të klientit.

Duke u bazuar në atë që u përshkrua më lartë, mund të themi se infrastruktura moderne bankare dhe investimi në teknologji më shumë se luks është parakusht për të komunikuar me klientët në tregun tonë dhe në kohën e sotme.

ProCredit Bank Kosova	2005	2010	2014	Tetor - 2015
Participimi i E-banking transaksioneve në numrin total të transaksioneve	0%	21%	60%	82%

Burime:

1. The effects of technology on the EU banking systems (July 1999) - ECB
2. Buletini Mujor Statistikor Nr. 169, publikuar më 5 Nëntor 2015 nga Banka Qendrore e Kosovës (<http://bqk-kos.org/?id=97>)
3. McKinsey & Company , artikuj te ndryshem
4. 10 Ways Technology Will Change Banking in 2015 (American Banker)

BIG MAC DHE PARITETI I FUQISË BLERËSE, PFB

Tipar tërheqës i Big Mac-ut si një tregues i PFB është përbërja e tij uniforme. Me pak përjashtime, elementet përbërëse të Big Mac janë të njëjta kudo rreth globit. Teoria e paritetit të fuqisë blerëse parashikon se monedha e një vendi do të zhvlerësohet me një shumë të barabartë me shtesën e inflacionit të brendshëm mbi inflacionin e jashtëm.

Big Mac-u është një hamburger i shitur nga McDonalds-i, një zinxhir ndërkombëtar restorantesh ushqimi të shpejtë. Ëroductet kryesore të kompanisë. Por ky artikull nuk është në lidhje me McDonalds-in, historinë e tij, produktet, e as të konsumit, dobishmërisë shëndetësore apo obesitetit të shkaktuar nga konsumi i Big-Mac-ut. Kjo është një tentativë për të nxjerrë në pah vlerën e Big Mac-ut si një masë e pëlqyeshme e PFB-së.

Tipar tërheqës i Big Mac-ut si një tregues i PFB është përbërja e tij uniforme. Me pak përjashtime, elementet përbërëse të Big Mac janë të njëjta kudo rreth globit. Për këtë arsye, Big Mac-u shërben si një shportë e përshtatshme e tregut të mallrave përmes së cilës fuqia blerëse e monedhave të ndryshme mund të krahasohet.

Indeksi i Big Mac-ut u zbulua nga "The Economist" në vitin 1986 si një udhëzues gazmorë për të parë nëse monedhat janë në nivelin e tyre të "duhur". Ajo është e bazuar në teorinë e paritetit të fuqisë blerëse (PFB), nocioni se në afat të gjatë normat e këmbimit duhet të lëvizin drejt normës që do të barazonte çmimet e një shporte të njëjtë të mallrave dhe shërbimeve (në këtë rast, një hamburger) në dy vende të ndryshme.

Z. XHEMAJL GASHI

MENAXHER I PORTFOLIOS

RAIFFEISEN BANK KOSOVO



Thjesht: një dollar duhet të blejë njëjtë kudo. PFB e Big Mac-ut është kursi i këmbimit që tregon se një hamburger kushton njëjtë si në Amerikë. Krahasimi i PFB-së me normën aktuale është një test që tregon nëse monedha është nënvlerësuar apo mbivlerësuar.

Kolona e parë e tabelës tregon çmimet e monedhës lokale për një Big Mac. E dyta i konverton ato në dollarë. Çmimi mesatar i një Big Mac-u në Amerikë është \$4.79. Hamburgerët më të lirë janë në Kinë dhe Rusi (\$2.74, \$1.88); më të shtrenjtët janë në Zvicër \$6.82. Me fjalë të tjera, monedhat më të nënvlerësuarat janë rubla Ruse dhe juani Kinez (-61%, -43%), franga zvicerane është monedha më e mbivlerësuar me 42 për qind. Kolona e tretë llogarit PFB-në e Big Mac-ut. Duke pjestuar çmimin lokal Rus me atë Amerikan, përfitojmë PFB prej 22.34 ruble. Norma aktuale e këmbimit është 56.82 rubla, duke lënë të kuptohet se monedha Ruse është nënvlerësuar për 61 për qind kundrejt dollarit. Për më tej, duke përpjestuar çmimin lokal Kinez me çmimin Amerikan, përfitojmë një dollar PFB me 3.55 juan. Norma aktuale e këmbimit është 6.21 juan, duke nënkuptuar se monedha Kineze është nënvlerësuar me 43 për qind kundrejt dollarit. Çmimi mesatar i një Big Mac-u në euro

Standardi i hamburgerëve, çmimet e Big Mac-ut

Shteti	Big Mac-u në monedhë lokale	Në dollarë	PFB e nënkuptuar e dollarit	Norma aktuale e këmbimit të dollarit më 8 Gusht 2015	Nën (-) mbi (+) vlerësimi kundrejt dollarit, %
Shtetet e Bashkuara	4.79	4.79			
Argjentina	28.00	3.07	5.85	9.14	-36
Australia	5.30	3.92	1.11	1.35	-18
Brazil	13.50	4.28	2.82	3.15	-11
Britani	2.89	4.51	0.60	0.64	-6
Kanada	5.85	4.54	1.22	1.29	-5
Kili	2,100.00	3.27	438.41	642.45	-32
Kina	17.00	2.74	3.55	6.21	-43
Egjipt	16.93	2.16	3.53	7.83	-55
Euro zona	3.70	4.05	0.77	0.91	-15
Hong Kong	19.20	2.48	4.01	7.75	-48
India	116.25	1.83	24.27	63.43	-62
Indonezia	30,500.00	2.29	6,367.43	13,344.50	-52
Izrael	17.50	4.63	3.65	3.78	-3
Japonia	370.00	2.99	77.24	123.94	-38
Malajzi	7.65	2.01	1.60	3.81	-58
Meksika	49.00	3.11	10.23	15.74	-35
Zelanda e Re	5.90	3.91	1.23	1.51	-18
Pakistan	350.00	3.44	73.07	101.70	-28
Peru	10.00	3.14	2.09	3.18	-34
Filipinet	163.00	3.61	34.03	45.21	-25
Rusia	107.00	1.88	22.34	56.82	-61
Arabia Saudite	12.00	3.20	2.51	3.75	-33
Singapori	4.70	3.44	0.98	1.37	-28
Afrika Jugore	26.00	2.09	5.43	12.41	-56
Korea Jugore	4,300.00	3.76	897.70	1,143.50	-21
Sri Lanka	350.00	2.61	73.07	133.85	-45
Zvicra	6.50	6.82	1.36	0.95	42
Taivan	79.00	2.55	16.49	31.02	-47
Tailanda	108.00	3.17	22.55	34.09	-34
Turqi	10.25	3.87	2.14	2.65	-19
Emiratet e Bashkuara Arabe	13.00	3.54	2.71	3.67	-26
Ukraina	34.00	1.55	7.10	21.95	-68
Urugvaj	113.00	4.13	23.59	27.35	-14
Venezuela	132.00	0.67	27.56	197.00	-86
Vietnam	60,000.00	2.75	12,526.10	21,810.00	-43

zonë është \$4.05. Kjo tregon se PFB e Euros është pikërisht \$0.77, kështu që në normën e tij aktuale prej \$0.91, Euro është 15 për qind e nënvlerësuar (mbivlerësuar 10 për qind në 22 Prill 2003). Shumica e monedhave të tregjeve në zhvillim janë nënvlerësuar kundrejt dollarit për afërsisht 50%. Të dhënat nuk tregojnë asnjë valutë që është pikërisht si PFB-ja e tyre. Një përjashtim bën Uoni i Koresë së Jugut, në përputhje me Indeksin e Big Mac-ut më 22 Prill 2003.

Gjatë rrjedhës së zymtë të vitit 2014, të gjitha monedhat në zhvillim u përmirësuan kundrejt dollarit Amerikan, të nxitura nga një monedhë e fortë Amerikane dhe një rënie të mprehtë në çmimet e mallrave përkundër prapavijës së dobët të rritjes globale (dhe tregtisë së lidhur botërore). Në reagim ndaj rënies së çmimeve të naftës së papërpunuar dhe sanksioneve ndërkombëtare të vendosura ndaj vendit në vijim të pushtimit të Ukrainës, rubla Ruse ndjeu korrigjimin më të madh.

Teoria e paritetit të fuqisë blerëse parashikon se monedha e një vendi do të zhvlerësohet me një shumë të barabartë me shtesën e inflacionit të brendshëm mbi inflacionin e jashtëm. Teoria gjithashtu parashikon që kursi i këmbimit i një vendi do të vlerësohet me një shumë të barabartë me shtesën e inflacionit të jashtëm mbi inflacionin e brendshëm. Teoria nuk konsideron ndikimin e lëvizjeve ndërkombëtare të kapitalit, dhe ndikohet nga zgjedhja e indeksit të duhur të çmimeve të përdorura në llogaritjet e çmimeve.

Pavarësisht papërsoshmërisë së teorisë PFB, ekonomistët e përdorin atë për të siguruar krahasime më të mira të mirëqenies në të gjitha vendet nga ajo cka mund të nxirret thjesht duke konvertuar pagat në kurset e këmbimit të tregut. Kurset e këmbimit duhet të përshtaten në mënyrë që punëtorët që merren me tregëtimin e mallrave të paguhen në përputhje me produktivitetin e tyre. Por, firmat që shesin mallra të pa-tregëtueshme dhe shërbime duhet të konkurrojnë me firmat në sektorin e mallrave të tregëtueshme për punëtorë. Pra, një vend me firma eksportuese me produktivitet të lartë do të ketë paga të larta në të gjithë sektorët, përfshirë edhe ato si, prerja e flokëve, ku dallimet e produktivitetit midis vendeve të pasura dhe të varfra janë të vogla. Si rezultat, kostoja e

jetesës është më e lartë në vendet e pasura, dhe korrigjimet e thjeshta të kurseve të këmbimit mbivlerësojnë diferencat e vërteta të mirëqenies. Në bazë të kursit të këmbimit, një Amerikan mesatar është 35 herë më i pasur se një Indian mesatar. Megjithatë, në bazë të PFB, duke marrë parasysh koston më të ulët të jetesës në Indi, të ardhurat amerikane janë vetëm 13 herë më të larta. (Banka Botërore mban një PFB databazë të dhënash për 180 vende).

Punëtorët në ekonomitë më pak produktive fitojnë paga më të ulëta, por Big Mac-ët e tyre kushtojë më pak për tu prodhuar. Për këtë arsye, hendeku në mirëqenien e punëtorëve në mes të vendeve të pasura dhe të varfra është më i vogël sesa që sugjerojnë kurset e këmbimit. Në Kinë, për shembull, kursi i këmbimit të rregulluar "McWage" është 11% i atij në Amerikë. Paga reale BMOP (Big Mac për Orë Pune) tregon një hendek shumë më të vogël. BMOP gjithashtu eliminon përparësinë në dukje që i jep paga minimale punonjësve në Europën perëndimore.

Është mbi apo nën vlerësimi i mirë apo i keq? Kjo varet nga ajo që qeveria përkatëse përpiket të arrij. Kursi i këmbimit është vetëm një prej instrumenteve të politikave makroekonomike në dispozicion të qeverisë për të ndihmuar në ruajtjen e ekuilibrit të brendshëm dhe të jashtëm të njëjtën kohë. Ky mund të jetë një instrument efektiv vetëm nëse përdoret në koordinim me instrumente tjera dhe mbështetet nga strukturat e kërkuara institucionale dhe rregullatore. Politika monetare është pjesë integrale e sistemit të kursit të këmbimit.

Për shembull, në qoftë se franga zvicerane mbivlerësohet në lidhje me dollarin, atëherë një turist zviceran që udhëton për në SHBA do të jetë shumë i lumtur. Në fakt, sa më shumë të mbivlerësohet franga, aq më mirë. Megjithatë, për një eksportues të mallrave zvicerane në SHBA, çmimi i tij në terma të dollarit do të jetë më i lartë për aq sa është frangu i mbivlerësuar. Prandaj, një frangë e mbivlerësuar me siguri do të zvogëlojë shitjet dhe fitimet për këto firma zvicerane.

METODOLOGJIA LEAN

“Kontrolloni fatin tuaj ose dikush tjetër do ta bëjë atë” Jack Welch, Jack: Nga parandjenja

Menaxhimi i konsiderueshëm brenda një korporate është i nevojshëm për një shërbim të mirë, cilësor dhe të vazhdueshëm, dhe më e rëndësishme sipas pritjeve të konsumatorëve. Sot, në botë janë duke u përdorur teknika të ndryshme për menaxhimin e konsiderueshëm që kanë për qëllim sigurimin e cilësisë në procese dhe shërbime, por edhe të përmirësojnë proceset dhe shërbimet në vazhdimësi. Më të zakonshme nga ato janë Lean, Six Sigma ose Menaxhimi Performancës së Biznesit.

Metodologjia LEAN, është një nga metodat më moderne e cila përdoret sot në industri të ndryshme për të përmirësuar cilësinë e produkteve dhe shërbimeve nëpërmjet katër (4) shtyllave; zëri i konsumatorit, sistemi operativ, infrastruktura e menaxhmentit, dhe mënyra e të menduarit në një dimension tjetër (të menduarit dhe sjellja).

Lean ka rrënjët e saj në Sistemin e Prodhimit Toyota (TPS) dhe është zhvilluar nga Toyota në vitet e 50-ta, dhe ka të bëjë me sjelljen e **efikasitetit dhe performancës superiore** në vendin e punës (**Gemba**)* duke tentuar vazhdimisht të përmirësojë proceset e punës nëpërmjet eliminimit të mbeturinave (**Muda**)* dhe proceseve që nuk shtojnë vlerë në organizatë.

Qëllimi i metodologjisë Lean është të përmbush nevojat eksplicite dhe implicite të konsumatorëve me konsumin sa më të ulët të burimeve dhe të ruajtjes së mjeteve të bankës duke eliminuar vazhdimisht mbeturinat, ndryshueshmërinë, dhe shtangimet, që do të thotë se me:

Znj. DRENUSHA SHEHU PULA

UDHËHEQËSE
E EKIPIT PËR
MENAXHIM TË
PROCESIT DHE
PRODUKTIVITETIT
RAIFFEISEN BANK



- Pak mbeturina do të kemi kosto më të ulët, cilësi më të mirë dhe të qëndrueshme
- Reduktimin e mungesës së fleksibilitetit që nënkupton ofrimin e asaj çfarë klienti dëshiron, kur e dëshiron, dhe në sasinë e duhur
- Reduktimin e ndryshueshmërisë që do të thotë, përmirësimin e procesit të besueshmërisë; pra, uljen e koston dhe përmirësimin e cilësisë

Shtylla themelore e Lean është zëri i klientit ku nevojat e klientëve dhe pritjet për shërbime identifikohen, për të vazhduar me:

Sistemi Operativ - mënyra se si procesi është konfiguruar dhe optimizuar për të krijuar vlerë dhe minimizuar humbjet.

Infrastruktura e Menaxhmentit- strukturat zyrtare dhe sistemet me të cilat burimet menaxhohen në mbështetje të procesit të shërbimit.

Të menduarit dhe Sjellja - mënyra se si njerëzit mendojnë, ndjejnë dhe sillen në bankë, individualisht dhe kolektivisht.


SISTEMI OPERATIV



“Mënyra se si një proces është i konfiguruar / optimizuar për të krijuar vlera”

- Parashikimi dhe menaxhimi i vlerave hyrëse (kërkesa)
- Modelimi i procesit nga fillimi deri në fund (rrjedha)
- Caktimi i personelit për të përmbush nevojat (kapaciteti)

INFRASTRUKTURA E MENAXHIMIT



“Strukturat dhe sistemet ku resurset (burimet) janë të menaxhuara”

- Menaxhimi i performances -transparenca dhe menaxhimi vizual
- Organizimi dhe aftësitë -përcaktimi i roleve, përgjegjësi dhe strukturave dhe dhënia e aftësive të duhura tek njerëzit

MENTALITETI & SJELLJET



“Mënyra se si njerëzit sillen individualisht dhe në mënyrë kolektive”

- Të kuptuarit dhe përkushtimi nga të gjithë të punësuarit
- Angazhim në të gjitha nivelet për zgjidhje të problemit dhe përmirësim të vazhdueshëm
- Modeli shembull nga menaxhmenti

Shtyllat janë korniza e Lean me qëllim për të na siguruar se gjatë një transformimi ne jemi duke i trajtuar të gjitha palët e përfshira: njerëzit, sistemet, dhe proceset. Transformimet Lean ndryshojnë nga projektet e rregullta si për menaxhimin e transformimit, veglave/ teknikave të përdorura.

Përderisa me projekte të rregullta, faktori i matjes së suksesit është arritja e objektivit të vendosur në fillim të projektit; në transformimet LEAN, faktori i matjes së suksesit është arritja e një objektivit të përcaktuar dhe ndikimi i tij, mirëmbajtja e ndryshimit dhe përmirësimi i vazhdueshëm.

Qëndrueshmëria e ndryshimit është çelësi i suksesit!

NJË MUNDËSI PËR PËRSHTYPJE TË PARË MBRESËLËNËSE

“Mirë apo keq, e vërtetë apo jo, e drejtë apo jo e drejtë, njerëzit do të na gjykojnë duke u bazuar në paraqitjen tonë, shtrëngimin e dores (përshendetjen), dhe sinjaleve joverbale para se të kemi rastin të themi ndonjë gjë.”

Jetojmë në një botë konkurruese. Çdo vit kemi breza të rinjë të të diplomuarve energjetik, të rinj dhe entuziastë që janë të gatshëm të përballen me vështirësitë e botës profesionale të biznesit, dhe të dëshmojnë se ata do të jenë më të vërtetë aseti potencial më i mirë i kompanisë apo të ndonjë institucioni. Ata janë të gatshëm që të ngjiten shkallëve të suksesit, dhe të bëjnë çka do që është e nevojshme për të arritur drejt karrieres së ëndërrave të tyre. Por në këtë det të madh të konkurrencës, sa prej tyre mund të tregojnë se ata janë njerëzit e duhur për këtë sfidë, para se ta kenë rastin ta dëshmojnë këtë me punën dhe aftësitë e tyre?

Znj. SHENAJ SHALA

MA NË PROTOKOL
NDËRKOMBËTAR DHE
AFTËSITË E DIPLOMACISË
SË BUTË

ZYRTARE NDËRLIDHËSE
PËR BALLKAN,

SHKOLLA
NDËRKOMBËTARE
PËR PROTOKOL DHE
DIPLOMACI (ISPD,
BRUKSEL)



Kosova, si shteti më i ri në Europë, dhe me popullatë më të re (rreth 70% e popullsisë nën 35 vjeç), e poashtu me nivel të lartë të papunësisë, paraqet një ambient sfidues për të gjithë punëkërkuësit. Atëherë si do të duhej të veprojmë? Çka mund të na veçojë nga konkurruesit tanë dhe të na dërgojë një hap më afer cakut tonë?



Besoni apo jo, hulumtimet tregojnë se njerëzit do të krijojnë një mendim dhe përshtypje për ne gjatë sekondave të parë të takimit tonë. Pa marr parasysh nëse takimi ynë është zyrtar, një intervistë pune, tubim shoqëror, apo negociatë biznesi, ne kemi vetëm disa sekonda për të krijuar përshtypje të parë të mirë, madje edhe para se të fillojmë që të flasim. Mirë apo keq, e vërtete apo jo, e drejtë apo jo e drejtë, njerëzit do të na gjykojnë duke u bazuar në paraqitjen tonë, shtrëngimin e dorës (përshendetjen), dhe sinjaleve joverbale para se të kemi rastin të themi ndonjë gjë. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që të jemi të prezentuar mirë/ të dukemi mirë, të kemi vetëbesim, dhe të buzëqeshim përderisa mbajmë kontaktin me sy dhe qëndrojmë drejtë kur takohemi me të tjerët.

Hulumtimet e mëtejshme bazojnë komunikimin efektiv kryesisht në gjuhën e trupit duke pohuar se përmes pozitave të ndryshme trupore dhe gjesteve tona, ne mund të përçojmë mesazhe që janë 12 deri në 13 herë më të fuqishme sesa fjalët përcjellëse. Çka do të thotë kjo, dhe si është kjo e mundur?

Gjuha e trupit përben një pjesë të rëndësishme të komunikimit tonë, përmes së ciles ne shprehim mendimet, qëllimet dhe ndjenjat tona përmes gjesteve, mimikës, të prekurit, përdorimit të hapësirës, etj. Nëse dijmë si të lexojmë gjuhën e trupit dhe si t'a përdorim atë, ne mund të rrisim ndikimin tonë dhe të veprojmë me vetëbesim më të lartë. Ne mund të krijojmë lidhje më të forta, mund t'i kuptojmë njerëzit më mirë, dhe t'ju tregojmë se ne kujdesemi për ta- nëse puna jonë përfshin punën me palë rregullisht.



Një shtrëngim-dore i fortë dhe solid do të na bëjë që të dukemi më kredibil brenda disa çasteve. Ne duhet të shtrëngojmë dorën mjaftueshëm- duke mos qenë shumë të vrazhdë, por edhe duke mos e bërë tepër të butë përshendetjen, pasi kjo zakonisht ndërlidhet me karakter të dobët. Një shtrëngim-dore i mirë do të ndërlidhet gjithnjë me vetëbesim, dhe do të duhet të përvetësohet, pasi është kontakti i parë (prekja) të cilën e kemi me të tjerët- duke e bërë këtë një ndër gjestet më të fuqishme.

Është poashtu me rëndësi që të **buzëqeshim dhe të mbajmë kontaktin me sy** kur prezentojemi (dhe gjatë bisedës me të tjerët). Në këtë mënyrë, ne shprehim sinqeritetin dhe respektin tonë, përderisa poashtu tregojmë interesim për atë se çka flitet. Megjithatë, në disa kultura kontakti me sy konsiderohet i vrazhdë dhe do të duhet të shmanget.

Përdorimi i hapësirës tonë personale duke e ngritur koken dhe mjekrën lartë, duke e drejtuar shpinën dhe gjoksin, dhe duke shtyrë supet pas, do të dërgojë sinjale të forta. Kjo do të tregojë se ndihemi rehat me veten, situatën në të cilën gjendemi, dhe njerëzit me të cilët jemi të rrethuar.

Shoqërimi i fjalëve tona me gjeste të duarve do të rrit vetëbesimin tonë edhe më shumë dhe do të bëjë të dukemi më pak të tendosur. Gjestet tona të duarve nuk duhet të jenë të tepruara, por vetëm të komplimentojnë fjalët tona. Lëvizjet duhet të jenë të relaksuara dhe të vijjnë



natyrshëm. Gjestet duhet përdorur me kujdes, pasi që ato nuk duhet të tërheqin vëmendjen e ndëgjuesit nga fjalët në duart tona.

Janë edhe disa gjeste negative të gjuhës së trupit të cilat do të duhej të evitohen gjatë situatave profesionale. Askush nuk dëshiron të bashkëpunoj me dikë që nuk është i përgatitur apo që nuk është i sigurtë në vete. Një person i pasigurtë zakonisht do të kryqëzoj duart, dhe këmbët gjatë qëndrimit, duke krijuar barrierë mbrojtëse mes vetes dhe njerëzve të tjerë. Kur **kryqëzojmë duart apo këmbët**, ne zakonisht nuk ndihemi rehat në atë situatë apo ambient të caktuar, prandaj mundohemi që nën vetëdije të kërkojmë rehati duke e 'përçafuar' veten dhe duke bllokuar botën e jashtme. Mënyra më e mirë që të evitohet ky gjest është që të mbajmë një laps apo ndonjë gjësend tjetër që do të pengonte kryqëzimin e duarve, apo thjeshtë t'i relaksojmë duart dhe t'i lëshojmë poshtë.

Një pozitë tjetër që do të duhej të evitohet është kur **ulemi me duar të mbledhura, me gjoksin tërhequr brenda**, dhe gjunjët e mbledhura që prekin njëra-tjetren. Në këtë pozitë ne bëhemi më të vegjël duke pas qëllimin që të 'zhdukemi' nga ambienti që na bën të ndihemi të pambrojtur dhe jo rehat. Ne zakonisht ndjejmë siklet kur trupi ynë është në këtë pozitë, dhe sa më në siklet që ndihemi në atë rreth, aq më shumë do mundohemi të zvogëlohem.

Mënyra më e mirë për të evituar këtë gjest është që të drejtohem/ulemi drejt, me gjoks të shtyer nga jashtë, dhe kokë dhe mjekër të ngritur lart. Nëse ne vazhdojmë që të ndihemi në siklet, atëherë kontrollimi i frymëmarrjes tonë, duke marrë frymë thellë, duke mbajtur frymën për disa sekonda dhe duke e lëshuar ngadalë, do të duhej të na relaksoj dhe të bëjë të ndihemi më pozitiv.

Një gjë është e sigurtë dhe duhet mbajtur në mend: në këtë botë të konkurrencës, mund ta kemi vetëm një mundësi- dhe disa sekonda, për të dëshmuar se ne jemi personi i duhur për bashkëpunim, duke lënë përshtypje të para të mira. Le të sigurohemi që këto përshtypje të jenë mbresëlënëse!



Sektori financiar i Kosovës përfaqësohet në Berlin

Në Berlin është mbajtur takimi vjetor i Fondit Europian për Evropën Juglindore (EFSE) ku morën pjesë lider të sektorëve financiar për Evropën juglindore. Panelist i ftuar për të përfaqësuar Kosovën ishte Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balijs. Në panel morën pjesë edhe Guvernatori i Bankës Qëndrore të Kroacisë z. Boris Vujcic, ish-Guvernatori i Bankës Qëndrore të Serbisë z. Radovan Jelasy, dhe përfaqësues tjerë nga

Holanda dhe Mbreteria e Bashkuar të cilët diskutuan për shumë zhvillime në arenën botërore financiare.

Në delegacionin nga Kosova morën pjesë edhe Guvernatori dhe zv. Guvernatori i Bankës Qëndrore të Kosovës, përfaqësues të institucioneve bankare dhe mikrofinanciare si dhe përfaqësues të zyres së EFSE në Kosovë.



Shoqata e Bankave të Kosovës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës



Shoqata e Bankave të Kosovës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës.

Më rastin e themelimit të Trupit Këshillëdhënës në Fakultetin Ekonomik, Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) dhe Fakultetit Ekonomik të Prishtinës kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi e cila ka për qëllim që të krijojë një partneritet publiko-privat që synon përmirësimin

e programeve studimore, zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe ofrimin e mundësive më të shumta për studentët që t'i aplikojnë njohuritë teorike në praktikë që do të ndikojë në rritjen e punësueshmërisë së tyre.

Marrëveshja është nënshkruar në njëren anë nga Dekani i Fakultetit Ekonomik të UP-së z. Skender Ahmeti dhe në anën tjetër nga Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave z. Petrit Balijs.

Panairi Financiar i Kosovës 2015

Më 29 shtator u hap Panairi Financiar i Kosovës në Pallatin e Rinisë në Prishtinë. Panairi filloi me hapjen solemne e cila u bë në hollin e Pallatit të Rinisë, me ç'rast guvernatori i Bankës Qëndrore z. Bedri Hamza theksoi rëndësinë e Panairit Financiar si dhe nënvizoi se roli i sistemit financiar në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit ka shënuar përmirësim të mëtejshëm në periudhën e fundit dhe atë kryesisht në saje të zhvillimeve në kuadër të aktivitetit të sektorit bankar.

Hapja solemne e Panairit u bë edhe nga kryetari i bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Ilir Aliu i cili në fjalën e tij hapëse tha se panairi është mundësi e mirë për dialog mes konsumatorëve dhe sektorit financiar, që të shohin inovacionet e zhvillimit në sektorin bankar. Ai po ashtu foli edhe për risitë që ka sjellë këtë vit panairi.



Panairi Financiar gjatë këtyre dy ditëve tërhoqi një numër të madh të vizitorëve të cilët paten mundësinë të njoftohen për së afërmi me ofertat e bankave, institucioneve mikrofinanciare, kompanive të auditimit, shkollave dhe instituteve të kontabilitetit, institucioneve edukativo-arsimore, si dhe programeve të ndryshme.

Përveç organizimit të ekspozimit të kompanive, në ditën e dytë të Panairit Financiar u mbajt edhe konferenca vjetore me temën "Financimi i Progresit në Kosovë". Kjo konferencë mbledhi në tavolinën e diskutimit akterët relevant për të trajtuar tema të ndryshme me rëndësi për sektorin financiar por edhe zhvillimin ekonomik të vendit. Ndër të tjera u diskutua për rëndësinë e agrobiznesit në zhvillimin ekonomik, sfidat dhe barrierat për qasje në financa për këtë sektor, si dhe çka duhet të ndërmerret nga të gjitha institucionet relevante për të arritur efekte sinergjike dhe për të arritur rezultate positive. Pjesë e diskutimit ishte edhe Fondi Kosovar për Garantim të Kredive. U diskutua se si financohet dhe cilat janë objektivat kryesore të këtij fondi dhe cilat janë efektet e mundshme mbi rritjen ekonomike dhe papunësinë.



Në lidhje me Panairin Financiar 2015, drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Balija theksoi se ky panair ka qenë ndër më të suksesshmit që kemi organizuar deri më tani. Vizitorët kanë pasur qasje të lehtë në Pallatin e Rinisë dhe kanë pasur mundësinë që të vizitojnë institucionet financiare që kanë ekspozuar shërbimet e tyre. Duhet të falenderojmë edhe



pjesëmarrësit e konferencës vjetore financiare, e cila ka rezultuar me një diskutim mjaft konstruktiv rreth rritjes së financimit për agrobiznesin. Gjithashtu me këtë rast është festuar 10 vjetori i Qendres për Trajnime Bankare pranë Shoqatës së Bankave të Kosovës ku janë falënderuar bashkëpunëtorët tanë me mirënjohje, shtoi në fund drejtori Balija.

Të gjitha konkluzionet nga konferenca vjetore e organizuar në kuadër të Panairit Financiar 2015 do të publikohen në numrin e shtatorit 2015 të Periodikut Bankar i cili do të jetë në dispozicion në webfaqen e Shoqatës së Bankave të Kosovës.



SHBK dhuroi shpërblimet e lojës shpërblyese “Panairi Financiar 2015”



Shoqata e Bankave të Kosovës bëri ndarjen e shpërblimeve tek fituesit e lojës shpërblyese në Panairin Financiar 2015. Kjo lojë shpërblyese ishte e hapur për të gjithë vizitorët e Panairit Financiar të mbajtur më datë 29 dhe 30 shtator në Pallatin e Rinisë në Prishtinë. .

Tërheqja e emrave fitues të lojës shpërblyese është bërë në emisionin “Koha për Financa” në Kohavision (<https://goo.gl/prj6W0>), ku pjesë e komisionit ishin përfaqësues nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Shoqata e Bankave të Kosovës.

Fituesit e kësaj loje shpërblyese janë:

1. Bahrije Maloku –Fituese e Laptop-it
2. Florim Berisha –Fitues I tabletit
3. Suzan Çoçaj –Fituese e Smartphonit

Shoqata e Bankave të Kosovës i falënderon të gjithë pjesëmarrësit e lojës shpërblyese “Panairi Financiar 2015”.

Ligjeratë për Edukimin Financiar nga Shoqata e Bankave të Kosovës në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë

Në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë më 21 nëntor 2015 u organizua Kuvendi i 8-të zgjedhor i Këshillit të Nxënësve të Kosovës të organizuar nga Këshilli Rinor Kosovar (OJQ). Në këtë event si folës prezantues mori pjesë Valon Shehu – trajner i certifikuar për Edukim Financiar përmes projektit për Edukim Financiar të Klientëve të Bankave të ndërmarrë nga Shoqata e Bankave të Kosovës dhe IFC. Z. Shehu dha një prezantim rreth kursimeve para 100 pjesëmarrësve kryesisht nxënës të shkollave të mesme.



U mbajt tryeza e rrumbullakët me temën “E drejta e transferimit të Qirambajtjes për pronat e privatizuara në Kosovë për 99 vite: Implikimet për bizneset, institucionet financiare dhe klientët e tyre”



Me datën 23 Korrik, 2015, zyra e Bankës Botërore në Kosovë ka organizuar tryezën e rrumbullakët me temën “E drejta e transferimit të Qirambajtjes për pronat e privatizuara në Kosovë për 99 vite: Implikimet për bizneset, institucionet financiare dhe klientët e tyre”

Në këtë tryezë u diskutua për të drejten e transferimit të Qirambajtjes dhe në veçanti për interpretimin ligjor të bërë së fundmi nga

Agjencia Kadastrale e Kosovës, në bazë të së cilës udhëzohet si të bëhet bartja e së drejtes së Qirambajtjes për 99 vite.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Agjencia e Privatizimit të Kosovës, Shoqata e Bankave të Kosovës, përfaqësues ligjor të pronarëve të pronave të privatizuara.

Mirëpritet banka ZIRAAT në Shoqatën e Bankave të Kosovës



Të Mërkurën, me 29 Korrik 2015, gjatë takimit të Bordit të Drejtorëve në Shoqatën e Bankave të Kosovës i është dorëzuar certifikata e anëtarësisë anëtarit më të ri ZIRAAT Bank, dega në Kosovë. Kjo është hera e parë që Drejtori Ekzekutiv i bankës ZIRAAT, z. Meriton Sunduri, merr pjesë

në mbledhjen e bordit, pas anëtarësimit. Në fund të takimit, z. Sunduri pranoi certifikatën e anëtarësisë me ç’rast kryetari i Bordit të Drejtorëve i shprehi mirëseardhje anëtarit më të ri në SHBK.

Bordi i drejtorëve në Shoqatën e Bankave të Kosovës zgjedh kryetarin e ri

Në takimin e fundit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) është bërë përzgjedhja e kryetarit të bordit të drejtorëve të SHBK-së. Me konsensus të plotë, kryetar i bordit të drejtorëve me një mandatë prej 2 vitesh u zgjodh z. Ilir. Aliu njëherësh edhe drejtor gjeneral i ProCredit Bank në Kosovë.

Me rastin e përzgjedhjes së tij në funksionin e kryetarit të bordit të drejtorëve z. Aliu tha "Sektori bankar në Kosovë është një ndër sektorët më të zhvilluar dhe modernizuar dhe gjithashtu një kontribues i fuqishëm i zhvillimit ekonomik të vendit. Andaj të jesh në krye të Shoqatës së Bankave, që njëherit është edhe zëri i industrisë bankare është një përgjegjësi por edhe nder i madh. Kontributi im në zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij sektori do të jetë i pa kursyeshëm në mënyrë që oferta e shërbimeve bankare të avancoj në çdo aspekt, por edhe ambienti i të bërit biznes të përmirësohet".

Ndërsa drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balija, me rastin e përzgjedhjes së kryesisë së re të bordit të drejtorëve tha " Detyra e kryetarit të bordit ka një rëndësi të



madhe për Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe sektorin financiar në Kosovë. Me këtë rast përgëzoj z. Ilir Aliu për zgjedhjen e tij dhe jam i sigurtë që z. Aliu do të kontribuojë fuqishëm në zhvillimin e mëtutjeshëm të industrisë bankare në Kosovë. "

Shoqata e Bankave të Kosovës është themeluar në vitin 2002 dhe përfaqëson gjithsej 9 banka komerciale, anëtare në SHBK.

Shoqata e Bankave të Kosovës ndan mirënjohje për z. Robert Wright

Shoqata e Bankave të Kosovës ndau mirënjohje për z. Robert Wright me rastin e përfundimit të suksesshëm të mandatit të tij të dytë si kryetar i bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK).

Wright gjatë kohës sa ishte kryetar i bordit të SHBK-së dha një kontribut të çmuar për sektorin bankar dhe punën e SHBK-së. Me rastin e dorëzimit të mirënjohjes tek z. Wright, drejtori ekzekutiv i SHBK-së z. Balija tha "Në emër të bordit të SHBK-së dhe në emër të tim personal kam nderin të prezantoj këtë mirënjohje për z. Wright, për përkushtimin e tij të jashtëzakonshëm në shërbimin e tij në pozitën e kryetarit të bordit të SHBK-së".



Në anën tjetër z. Wright ishte falënderues për këtë mirënjohje duke thënë "Ka qenë kënaqësi dhe nder të jem Kryetar i Bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës gjatë dy mandateve të njëpasnjëshme dhe të jem i përfshirë në shumë zhvillime pozitive brenda industrisë bankare gjatë kësaj kohe. I falënderoj sinqerisht kolegët e Bordit për gjithë përkushtimin dhe bashkëpunimin e tyre gjatë kohës sime si Kryetar, dhe gjithashtu do të doja të shpreh falënderimet e veçanta për z. Petrit Balija dhe ekipin e tij në SHBK për përkrahjen shumë

profesionale dhe udhëzimet që na kanë ofruar gjatë 4 viteve të kaluara. I dëshiroj z. Ilir Aliut, nga banka ProCredit të gjitha sukseset si Kryetar i ri i Bordit në SHBK."

Z. Wright, njëherit edhe drejtor gjeneral i Raiffeisen Bank në Kosovë, është zgjedhur nga Bordi që të shërbej si zëvendës kryetarë i Bordit për një mandat të ri gjatë të cilit kryetar i bordit do të jetë z. Ilir Aliu, drejtor gjeneral i bankës ProCredit.

T.C. ZIRAAT BANKASI A.S. – dega në Kosovë anëtarësohet në Shoqatën e Bankave të Kosovës

Që nga korriku i këtij viti, në Shoqatën e Bankave të Kosovës është shtuar një bankë anëtare. Kjo është banka T.C. ZIRAAT BANKASI A.S. – dega në Kosovë. Ziraat Bank është themeluar në vitin 1863 ndërsa konsiderohet se është njëra ndër bankat më të mëdha në Turqi. Ziraat Bank është një bankë sovrane (kapitali aksionar i Bankës është 100% në pronësi të Nënsekretariatit Turk të Thesarit). Deri më 31 Dhjetor 2014 rrjeti i Ziraat Bank përfshinte 1682 degë lokale dhe 25 degë ndërkombëtare. Banka, në përputhje me strategjinë e saj bankare ndërkombëtare, synon të siguroj produkte e shërbime bankare të korporatave dhe individëve përmes një strukture të mirë dhe tregu të definuar dhe një modeli të biznesit të orientuar drejt klientëve në Kosovë.

Për anëtarësimin e Ziraat Bank në Shoqatën e Bankave të Kosovës, Menaxheri i degës në Kosovë z. Meriton Sunduri tha se "Është kënaqësi e jona që të jem anëtarë në Shoqatën e Bankave të Kosovës si dhe e mirëpresim bashkëpunimin gjatë viteve të ardhshme të rritjes sonë në Kosovë". Kurse, nga Shoqata e Bankave të Kosovës z. Petrit Balija, deklaroi se "Është një nder i madh të kemi një bankë dhe investitorë të tillë në Kosovë siç është Ziraat Bank. Mendoj se Ziraat Bank do të kontribuoj



shumë pozitivisht në rritjen e qasjes në financa për qytetarët e Kosovës dhe bizneset në Kosovë. Kjo bankë sjell një përvojë të jashtëzakonshme duke pas parasysh që është një ndër bankat më të vjetra dhe më të mëdha në rajon dhe më gjerë. Ne si Shoqatë e Bankave të Kosovës do të jemi në mbështetje të plotë të stafit dhe menaxhmentit të Ziraat Bankës."

Banka të sigurta në Kosovë dhe Shqipëri

Shoqata e Bankave të Kosovës më 26 nëntor 2015 mori pjesë në Forumin Kombëtar për Siguri Bankare në Tiranë. Hapja solemne është bërë nga drejtuesit e Shoqatave të bankave, respektivisht nga Kosova z.Petrit Balija dhe nga Shqipëria znj. Endrita Xhaferi.

Z.Balija me këtë rast tha se siguria e klientëve të bankave është një prej objektivave kryesorë në zhvillimin e sektorit bankar në Kosovë. Ai potencoi rëndësinë që ka ofrimi i shërbimeve të shpejta, të lehta dhe mbi të gjitha të sigurta për klientët e bankave. Në konferencë janë të ftuar edhe përfaqësues të institucioneve shtetërore të sigurisë.



Komitetet në Shoqatën e Bankave të Kosovës Përzgjedhin Kryesinë e Re

Në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) funksionojnë dhjetë komitete të fushave të ndryshme të sektorit bankar. Komitetet përbëhen nga përfaqësues respektiv të nëntë anëtarëve të SHBK-së. Komitetet kanë funksione tejet të rëndësishme për të trajtuar çështje specifike që ndikojnë në funksionimin më të

mirë të sektorit. Gjatë vitit 2015 u bë përzgjedhja e kryesisë së re në disa nga komitetet aktive në SHBK.

Komitetet të cilat kanë përzgjedhë kryesinë e re janë:

Emri i komitetit	Kryetari i përzgjedhur	Institucioni	Nënkryetari i përzgjedhur	Institucioni	Data e përzgjedhjes së kryesisë së re
Komiteti i Sigurisë	Vullnet Shkodra	BEK	Agon Gashi	RBKO	9 shkurt 2015
Komiteti i Pagesave	Akile Cërnobregu	PCB	Boryana Mustafa	NLB	12 shkurt 2015
Komiteti për Parandalimin e Mashtrimeve me Kartela	Modest Morina	RBKO	Arben Islami	BpB	19 shkurt 2015
Komiteti i Thesarit	Arianit Dehiri	TEB	Berat Isa	RBKO	27 mars 2015
Komiteti i Burimeve Njerëzore	Arta Celina	RBKO	Donika Karaxha	TEB	18 gusht 2015

Ashtu siç edhe është e përcaktuar në procedurat e punës së këtyre komiteteve, mandati i kryesisë së re është dyvjeçar.

Drejtori Ekzekutiv i SHBK-së z. Petrit Balija dhe stafi i SHBK-së shfrytëzojnë rastin të falënderoj

të gjithë përfaqësuesit e kryesive të kaluara për punën dhe kontributin e palodhshëm të dhënë gjatë mandatit të tyre, përderisa ju dëshiron shumë suksese kryesive të reja të zgjedhura.

Banka Ekonomike mbështet kongresin e dytë ndërkombëtar të oftamologëve



Në kuadër të përkushtimit të vazhdueshëm të Bankës Ekonomike për mbështetjen e organizimeve të cilat ngritin nivelin e vetëdijesimit dhe përgjegjësisë sociale, me theks të veçantë në sektorë me të cilat është e lidhur direkt edhe mirëqenia e shoqërisë së vendit tonë, Banka Ekonomike mbështet organizimin e "Kongresit të dytë Ndërkombëtar të Oftamologëve", i cili mbahet me 20 Et 21 Nëntor 2015 në Hotel Emerald.

Ky kongres ka për qëllim edukimin e vazhdueshëm profesional si dhe shkëmbimin e përvojave me ligjërues të njohur ndërkombëtar të cilët do ti

ndajnë përvojat e tyre në diagnostifikimin dhe trajtimin modern të shumë sëmundjeve të cilat ne i hasim çdo ditë në praktikën tonë, gjë që do të rezultojë në ngritjen e kujdesit personal dhe ruajtjen e shëndetit pamar.

Banka Ekonomike do të vazhdoj të kontribuoj në ngritjen e përgjegjësisë në shoqërinë tonë dhe zhvillimit të përgjithshëm profesional dhe shoqërorë.

Banka Kombetare Tregtare ndihmon femijet e prekur me semundjen e kancerit



BKT si pjesë e shoqërisë Kosovare, është e dedikuar që të ndihmojë dhe kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë në të gjitha sferat, në vazhdimësi.

Dedikimin e saj ndaj përgjegjësisë sociale, BKT e tregon përmes sponsorizimeve dhe aktiviteteve të bamirësisë përmes së cilave reflekton vlerat e institucionit.

BKT së fundmi u angazhua në projektin që u zhvillua për sensibilizimin e popullatës në ekzaminimin e hershëm të sëmundjes së kancerit tek fëmijët. Projekti i organizuar në formë të një sfilate mode nga kreatorja Aferdita

Paqarada në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, mundësoi mbledhjen e fondeve për repartin e Onkologjisë dhe Hematologjisë në Klinikën e Pediatrisë në QKUK, fonde të cilat do të përdoren për blerjen e materialit I cili nevojitet për diagnostifikim të kancerit.

BKT angazhohet që në mënyre pozitive të prek jetën e secilit duke e zgjeruar aktivitetin e saj bamirës në fusha të ndryshme të shoqërisë dhe kulturës.

BPB sjellë buzëqeshje nxënësve të shkollës fillore Tefik Çanga



Këtë herë BPB në fokus i kishte më të shtrenjtët tanë, fëmijët. Pikërisht nxënësit e klasave 1-9 të shkollës fillore Tefik Çanga në fshatin Koliq, Ballaban, dhe Podaj të komunës së Prishtinës. BPB vendosi ti befasojë me nga një dhuratë simbolike që përbehej nga mjete shkollore (ngjyra, lapsa, blloqe të vizatimit, goma, etj)

98 nxënës të cilët udhëtojnë në degët e kësaj shkolle në këto tri fshatra.

Ne e dimë që për nxënësit tanë kurrë nuk është mjaft me lapsa e ngjyra...Kurrë nuk është pak kur sjellim buzëqeshje :)



Bizneset slllovene të interesuara për investime në fushën e mjedisit

NLB  Prishtina



Në Prishtinë u mbajt konferenca “Projektet slllovene për zhvillimin e mjedisit në Kosovë”, që u organizua nga Ambasada e Republikës së Sllovenisë në Kosovë dhe Konzorciumi për teknologjitë e gjelbra për mjedisin i kompanive slllovene, me mbështetjen e bankës NLB Prishtina dhe Klubit të Bizneseve Slllovene - EAC dhe “Spirit Slllovenia”, si dhe Oda Ekonomike e Kosovës (OEK).

“NLB Prishtina vazhdimisht i ka dhënë rëndësi projekteve ekologjike dhe të ambientit, disa herë kemi financuar projekte për kompani të ndryshme si dhe për individ të cilët bëjnë

blerjen e pajisjeve të reja apo edhe ndërtimin e hidrocentraleve, gjithashtu edhe të termoizolimeve të shtëpive”, theksoi Selimi, ndihmës i kryetarit të bordit udhëheqës për korporata në NLB Prishtina.

Selimi tha se NLB grup i ka të aprovuara politikat e ambientit dhe politikat sociale për përgjegjësinë shoqërore prandaj sipas tij kjo bankë është e detyruar të integroj këto politika dhe i zbaton në punë të përditshme. NLB, është e gatshme të mbështes financiarisht këso lloj projektesh deri në 12 milionë euro.



Banka Raiffeisen vazhdon përkrahjen për Federatën e Futbollit të Kosovës



Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar bashkëpunimin me Federatën e Futbollit të Kosovës (FFK) edhe për një vit, ky është viti i tetë me radhe që Banka Raiffeisen përkrah Federatën e Futbollit të Kosovës. Në Konferencën për media, të organizuar nga FFK, Fadil Vokrri, Kryetari i FFK-së dhe Robert Wright, Drejtor ekzekutiv i Bankës Raiffeisen nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit edhe për një vit.



Banka ProCredit edhe këtë vit mbështet Dokufest-in



Edhe këtë vit për të 11-tinë me radhë, banka ProCredit ka konfirmuar mbështetjen e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Shkurtër dhe Dokumentar – Dokufest, si sponsor gjeneral i kësaj ngjarje të rëndësishme kulturore në vend.

Pas 14 vjetësh të mbajtjes së këtij festivali, sot DokuFest është ngjarja më e madhe kulturore në vend dhe një ndër 25 festivalet më të mira të filmit dokumentar në botë.

Në edicionin e sivjetmë të Dokufestit u shfaqen 228 filma nga 43 vende të botës në

6 programe garuese. Kjo ngjarje kulturore tërhoqi vëmendjen e një numri të madh artistësh, film bërësve, producentëve dhe artdashësve nga rajoni dhe bota.

“Banka ProCredit Bank si një institucion që vazhdimisht mbështet ngjarjet e mirëfillta në Kosovë e posaçërisht ato që kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejt në zhvillimin e kulturës, ka besuar në DokuFest që nga vitet e para, duke qenë një ndër mbështetësit kryesor për 11 vjet radhazi” tha Albena Çarkaxhiu menaxhere e departamentit të Marketingut dhe PR në ProCredit Bank.

e-Statement, shërbimi më i ri i lancuar nga Banka ProCredit

Banka ProCredit ka lancuar shërbimin e ri të quajtur "e-Statement."

Ky shërbim mundëson shikimin e gjendjes së llogarisë online duke u qasur përmes emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit.

Ndërsa përdoruesit e platformës e-Banking vazhdojnë të qasen përmes: emrit të përdoruesit, fjalëkalimit dhe tokenit.

Cilat janë llogaritë që mund të shihen me e-Statement?

- Bilanci i llogarisë rrjedhëse
- Bilanci i llogarisë së kursimit
- Bilanci i llogarisë më afat
- Bilanci i kredisë
- Bilanci i kartelës së kreditit

Plotësimi i nevojave të klientëve si dhe ruajta e mjedisit ku veprojmë ne është prioriteti ynë!

ProCredit Bank vazhdimisht është duke avancuar në shërbimet elektronike të cilat janë të dobishme dhe lehtësojnë menaxhimin e financave tuaja dhe kontribuojnë në një ambient më të pastër.

Me e-Statement klientët nuk kanë nevojë më të shtypin në letër gjendjen e llogarisë së tyre sepse në çdo kohë mund të qasen nga kompjuteri i tyre dhe ta shikojnë atë.

Më pak letër, mjedis më të pastër!

TEB SH.A promovon ndërrmarësinë dhe iniciativat Start Up si mundësi e zhvillimit personal dhe ekonomik



TEB SH.A vlerëson maksimalisht ndërmarrësit në veçanti dhe ndërrmarësinë si koncept pasi që i përcepton si krijues të vlerave të reja të cilat kanë efekte të shumëfishta pozitive për komunitetin. Në këtë mënyrë, banka hyri në bashkëpunim me Innovation Centre Kosova – ICK dhe filloi mentorimin e 7 ndërmarrësve inovativ me qëllim që ti zhvillojë dhe adaptojë biznes planet e tyre sipas nevojave të investuesve. Iniciativa e njejtë u aplikua edhe në qytetin e Gjakovës ku në bashkëpunim me Gjakova Innovation Centre u trajnuan dhe u inkuorpuan në program 5 ndërrmarës shtesë.

Si pjesë e kësaj programe zhvillimore, banka ka punuar intenzivisht në të dy pjesët e eko-

sistemit: anën e kërkesës dhe anën e ofertës. Në anën e kërkesës banka është angazhuar për stimulimin e ndërrmarësisë duke ofruar mentorim të kualitetit të lartë kurse në anën e ofertës ka promovuar programën tek investuesit potencial në Kosovë dhe në qendra të rëndësishme të diasporës si ajo në Zvicër dhe në Gjermani. Kjo qasje sinjalizon intencën e bankës për themelimin e një shoqërie të investuesve e cila do të shërbejë si gurëthemel i zhvillimit të sistemit të ndërrmarësisë. Nëpërmjet këtij eventi, banka synon të promovojë 'Programën e Ndërrmarësisë publikut të gjerë si dhe të ngrit vetëdijen për mundësitë të cilat i sjell ndërrmarësia.

Publikimet e Shoqatës së Bankave të Kosovës

“The Kosovo Banker” është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Revista botohet dy herë në vit dhe ka për qëllim të informojë saktë publikun lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Për më tepër informata, drejtohuni tek web faqja e

Shoqatës së Bankave të Kosovës www.bankassoc-kos.com.

Revistat e botuara:



“Vështrimi Periodik mbi Sektorin Financiar të Kosovës” është botim mujor i Shoqatës së Bankave të Kosovës duke filluar me publikimin e parë në muajin janar të vitit 2014. Publikimet mujore përmbajnë të dhëna dhe vlerësime të përgjithshme mbi sistemin financiar në Kosovë.

Çdo publikim mujor do të trajtojë çështje të caktuara të sistemit financiar që për vëmendje kryesore do të kenë sektorin bankar në Kosovë. www.bankassoc-kos.com.

Publikimet mujore të publikuara deri më tani:

Viti 2014



Viti 2015



Qendra për Trajnime Bankare

264
TRAJNIME

3022
TË TRAJNUAR

6336
ORË MËSIMI

2005-2015



Festojme 10 vjet sukses
Celebrating 10 years of success



Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit, kontaktoni Qendrën për Trajnime Bankare në Shoqatën e Bankave të Kosovës:

038 246 171
kbtraining@bankassoc-kos.com
www.bankassoc-kos.com



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION